



## OPINION

Arjan Soraj

### Bogova, burimi i rrezikuar

Page 4

## VËZHGIM

### Më në fund bashkia e Beratit me këshill kulture... të paligjshëm

Page 2

## STRES

Bujar Orizaj

### Braçe gënjen sot e gjithë ditën

Page 5

## OPINION

Anastas Pjetri

### Paga e mësuesëve, politika dhe aritmetika

Page 6

## EDITORIAL

### Parlamenti i qytetit në fund të mandatit

Janë muajt e fundit të mandatit të parlamentit të qytetit tonë, këshillit të bashkisë. Kanë kaluar afro tre vjet në karriget e nderuara si përfaqësues të qytetarëve. Ky këshill, natyrisht ka marrë vendime mjaft të rëndësishme në të mirë të përmirësimit të jetës së banorëve të Beratit. Aty është diskutuar, është debatuar dhe në fund është marrë vendim, në shumicën e rasteve me forcën e kartonave. Këshilltarët socialistë kanë qenë shumicë gjatë dy mandateve të qeverisjes vendore, ndërsa demokratët dhe disa këshilltarë afër tyre kanë qenë në opozitë. Për një banor të vëmendshëm ky këshill ka bërë një jetë rutinore, pa veprime të guximshme, pa nisma kurajoze në të mirë të qytetit dhe qytetarëve, pa këmbëngulje për të ndryshuar, për t'i dalë ballas së keqes. Në përgjithësi ky këshill ka miratuar ose ka kundërshtuar pa u thelluar, pa e vlarë shumë mendjen, madje në shumicën e herës pa u mbledhur edhe komisionet e këtij këshilli. Ende nuk kemi vendime që të jenë hartuar nga këshilltarë të veçantë, vendime që për nga rëndësia në jetën e qytetit, mund të mbeteshin si vendime me emrin e këshilltarit formulues. Këshilli i bashkisë nuk mundi të ndalë ndërtimet pa leje, nuk mundi të luftojë papunësinë dhe varfërinë e këtij qyteti, nuk mundi të rriste qytetin shpirtërisht nëpërmjet politikave kulturore dhe artistike, nuk mundi të sigurote shërbime sasiore dhe cilësore për qytetarët, nuk mundi të ndikonte për ta bërë më njerëzor shërbimin shëndetsor, nuk mundi të sigurote një shërbim arsimor cilësor, nuk mundi të sigurote më shumë ujë të bollshëm dhe të pastër në rubineta, nuk mundi të sigurote më shumë ndriçim në rrugë dhe rrugica. Disa këshilltarë ende nuk janë as vetë të vetëdijshëm se përse janë ulur në ato karrige të nderuara.

Në zgjedhjet e zhvilluara për qeverisjen vendore në vitin 2003 pati mjaft përfolje për manipulime me votat e qytetarëve. Disa këshilltarë u zgjedhën me telefon celularë në çastet e fundit, duke i njollësuar zgjedhjet dhe duke bërë pis karriget e nderuara të parlamentit të qytetit.

Tani po afron koha e rinovimit të kreut të bashkisë dhe këshillit bashkiak. Qytetarët e vëmendshëm kanë regjistruar në kujtesën e tyre punën e kësaj bashkie dhe të këtij këshilli dhe kur të vijë dita e votimit do të bëjnë korrigjimet e duhura, natyrisht në të mirë të qytetit, në të mirë të banorëve të tij.

Yzedin Hima



Berat, 23 prill 2006

### Urim

Urojmë gjithë  
besimtarët  
ortodoksë:  
"Gëzuar  
Pashkët!"

Lajmëtari

Ndërtimet pa leje po  
shtohen nga ditë më  
me zell

Page 5

Ajet Nallbani

Berati, kronika  
e jetës qytetare

Page 10

### Rrëfenja

nga Agim Mehqemeja,  
Namik Selmani

Page 14

Faqja  
sportive

nga Vlash Pambuku  
Rushan Dosti

Page 15-16

Jon Impex

Agjensi transporti udhëtarësh

Bileta autobusi për Greqi (Janinë-  
Rio- Athinë)

Bileta trageti për Itali

Bileta avioni për Itali

19 EURO (Pa taksa)

Tel. 032 31 565

Cel: 068 22 63 650

Lagjja: "22 Tetori" pranë Bar "Prince"

## Si mund të mbron automjetet tuaja?

TEXACO



Goma të ndryshme

ALDOM

Përdorni vajra të cilësisë së lartë

KËTU DO TË GJENI me shumicë dhe pakicë:

Shell



FILTRA



Bateri të cilësisë  
së lartë

Pjesë këmbimi me porosi për automjete të rënda (eskavator, fadrom, traktor, kamion, etj)

Adresa:

Tek Parku i Urës Vajguore  
Përballë Western Union

Administrator: Edison Fitim Beshiri  
Tel: 0682235888; 0692052522

# Më në fund bashkia e Beratit me këshill kulture... të paligjshëm

Bashkia e Beratit nuk ka patur këshill kulture, ndonëse ligji e detyron të ngrejë një këshill kulture, i cili do të nxiste veprimtarinë kulturore e artistike në qytetin e Beratit. Këshilli i kulturës nuk u ngrit gjatë këtyre viteve. Shkaqet nuk janë fort të qarta, por një fakt duket qartë si drita e diellit: këshilli i bashkisë nuk e ka vuar mendjen për kulturën, artin dhe letërsinë në këtë qytet. Ai ka marrë vendime për t'i akorduar qendrës kulturore të bashkisë Berat çdo vit mbi 6 milionë lekë të reja për t'u përdorur për shfaqje e veprimtari

kulturore. Këshilli i bashkisë Berat nuk e ka vuar mendjen si, ku, sa, pse do të përdoren këto lekë të taksapaguesve shqiptarë. Vetëm ka ngritur dorën për të akorduar këtë fond që, së bashku me një fond prej 6-7 milionësh për paga të punonjësve të kulturës shkon te 120 mijë dollarëshi. Veprimtaritë kulturore në Berat ka vite që mungojnë. Bëhet një shfaqje në vit me gjimnazistët (shfaqje krejt amatore dhe e gjithë shuma e akorduar nga këshilli i bashkisë shkon kot. Se mungojnë projektet kulturorë e artistikë, se edhe kur këto projekte janë

paraqitur në bashki, ato janë hedhur në koshin e letrave për shkaqe ideologjike).

Këshilli i kulturës ku duhet të bënin pjesë individë që kanë merita artistike që u peshon mendimi e fjala, nuk do të lejonin që jeta kulturore dhe artistike në qytetin e Beratit të ishte kaq e mjerë. Do të ndihmonin në përzgjedhjen e projekteve, në sugjerimet për këshillin e bashkisë dhe kryetarin e kësaj bashkie për ringritjen e kulturës e artit në këtë qytet.

Pas disa viteve pa këshill kulture më në fund bashkia e Beratit u bë me këshill kulture... po të

paligjshëm. Në një nga mbledhjet e fundit të këshillit të bashkisë u miratua formimi i këshillit të kulturës. Ky vendim u mor ndërkohë që po skadon mandati i këtij këshilli bashkie dhe zgjedhjet e reja për pushtetin vendor po afrohen. "Më mirë vonë se kurrë", kanë thënë bashkiakët tanë, por vendimi i tyre ka formësuar një këshill kulture të paligjshëm. Ja lista e këshillit të kulturës së bashkisë Berat: Shpëtim Dyrmishi, Agron Polovina, Alma Prendi, Avenir Bejo, Agron Gjyzari, Vladimir Skëndo, Ajet Nallbani. Siç shihet në këshillin e kulturës bëjnë



pjesë drejtori i saporikthyer i qendrës kulturore Shpëtim Dyrmishi, drejtori i galerisë së artit Agron Polovina, të dy në kundërshtim me ligjin. Nuk e kuptojmë si e kanë miratuar këtë listë

këshilltarët e nderuar të bashkisë së Beratit që marrin vendime konform ligjit.

Nuk dihet nëse prefekti i qarkut të Beratit e ka miratuar këtë vendim në kundërshtim me ligjin.

Lajmëtar



## Burgim pa afat për ish-komisarin Dida

Ish- drejtori i policisë së Beratit, Ilirjan Dida, është paraqitur sërish dy ditë më parë para togave të zeza në Gjykatën e Faktit. Por dje ai ka qëndruar në një seancë që zgjati më shumë se 4 orë, për "revokim të masës së arrestit". Ish-komisari, që gjykohej për vrasje, mbërriti në gjykatë i lidhur me pranga dhe nën masa të forta sigurie, rreth orës 11.00, me një makinë të burgut numër 302 në Tiranë. Ai u fut menjëherë në sallën e katit të parë të gjykatës. Seanca e djeshme është zhvilluar me dyer të mbyllura dhe siç mësohet nga burime të sigurta, pati debate shumë të ashpra mes avokatit të Didës, ardhur nga kryeqyteti, dhe prokurorit të Krimeve të Rënda, po nga Tirana, Anton Martini. Gjykata e Beratit deklaroi për gazetën se ishte e detyruar të zhvillonte seancën, edhe pse ishte e diel, sepse pikërisht në këtë ditë Didës i skadonte afati ligjor i paraburgimit. Në dosjen penale në ngarkim të tij ende nuk ka prova të mjaftueshme për të nisur hetimet gjyqësore për dy akuzat e rënda ndaj ish-komisarit. Ishte kërkesa e prokurorit Martini, për shtyrjen e afatit të paraburgimit të Didës, ajo që ka acaruar seancën, sepse avokati i ish-komisarit ishte dakord për vazhdimin e hetimeve, por jo me shtyrjen e afatit të paraburgimit. Avokati i Didës ka kërkuar që klienti i tij të hetohej në gjendje të lirë dhe jo të mbahej në birucë. Pas katër orë debatesh, gjyqtarja Margarita Buhali, ka marrë në konsideratë kërkesën e prokurorit për t'i njohur edhe një tjetër akuzë Didës, atë të "shpërdorimit të detyrës", dhe vendosi për të masën e re të sigurisë "arrest në burg pa afat" ose "deri në fund të hetimeve të Prokurorisë së Krimeve të Rënda".

Ish- komisari akuzohet për vrasjen e Dritan Zhupës (Shuahipi), 29 vjeç, në mars të vitit 2001, në përpjekje me policinë, në afërsi të banesës së tij në lagjen "Çlirimi" të qytetit të Beratit, ndërsa kthehej me kalë nga fshati Tërpan, si dhe për vrasjen e Gjergji Gushalit, 30 vjeç, në dhjetor të vitit 2001, i cili u gjend pesë ditë më vonë, me disa plumba në kokë e gjoks, i futur në një thes dhe i hedhur në kanal in anë rrugës nacionale Berat -Lushnje.

## Farmacistët bojkotojnë recetat e rimbursuara

Sindikata e farmacistëve të qarkut të Beratit, pasi është njohur me listen e re të barnave të rimbursimit dhe me kontratën 2006, ka vendosur në mënyrë unanime që të mos pranojë listen e re të barnave të rimbursuara me keto marzhe tregtimi.

Sipas tyre, ISKSh-ja nuk ka njoftuar dy muaj me para ndryshimin e listes së barnave sipas aktmarreshes se arritur midis paleve duke i shkaktuar një humbje të madhe biznesit. Kryetari i sindikates së farmacistëve të qarkut Berat, Ali Demaj, është shprehur për gazetën:

"Ne nuk do të pranojmë kontratën e vitit 2006 si të njeanshme dhe të mos krijojmë anomali në punën tonë perfaqesuesit e ministrisë, ne si sindikate i kemi drejtuar me një petition ministrit të Shëndetësisë, Maksim Cikuli, drejtoreshes

ISKSH-se, Elvana Hana, ku ne kete petition kemi kerkuar qe keto institucione te mos krijojne anomali ne punen e farmacisteve".

Me tej Demaj është shprehur se në nuk do të pranojë me listen e re të barnave të rimbursimit me keto marzhe tregtimi. Sipas Demajt, gjatë një muaji prane këtyre farmacive ekzekutohen 12 mijë receta në 17 farmacite e këtij rajoni. Tashme keto receta nuk do të gjejnë me ekzekutimin e tyre nga dora e këtyre farmacistëve.

"Ne nuk do të lejojmë me që ne kurriz të farmacistëve të behen lojtera të tilla,- ka thënë Demaj.- Nuk është faji yne që shume të semure do të mbeten pa ilaçet perkatëse, por i ministrisë dhe nendegeve të saj".

Dilaver Xhelili

## Uji i ndotur rrezikon mbylljen e 7 ujësjesve

Ndotja e ujit të vendburimeve që furnizojnë ujësjesit rajonale në qarkun e Beratit, rrezikon të çojë në mbylljen e 7 ujësjesve, një pjesë e të cilëve janë ende në ndertim. Ujësjesi i Ures Vajgurore, i cili kohe me para perdorej si uje industrial per ish-kombinatit tekstil, vitet e fundit nisi të perdorej si uje i pijshem per banoret e ketij qyteti.

Ndërsa uji i vendburimit të Çiflikut ka rezultuar me gaz sulfidrik, ashtu si vendburimi i Banajt, Sinjes, Arrezës dhe Mbreshtanit, të cilët pas analizave të kryera, uji i tyre ka dale i ndotur. Ndertimi i një pjesë të këtyre ujësjesve nisi në kohën e fushatës elektorale dhe duket se perqendrimi me teper tek vota se investimi, solli kete rezultat qe po i çon drejt mbylljes keta ujësjes, edhe pse ende nuk kane perfunduar punimet per ndertimin e tyre.

Per ndertimin e një ujësjesi në vendburimin e Banajt, shteti ka akorduar shumën prej 220 milione lekesh të vjetra, per ndertimin e ujësjesit në Arrëz janë dhene 100 milione leke të vjetra, ndërsa per ujësjesin e Sinjes janë dhene 220 milione leke të vjetra, investime të cilat rrezikojnë të shkojnë kot. Burime nga drejtorja e shëndetit publik bejne të ditur se specialistet e kesaj sfere po bejne çdo dite monitorimin e ujit ku pas çdo analize ditore të kryer, uji del me të njejtin nivel ndotjeje, e cila rrezikon seriozisht jetën e këtyre banoreve.

Nderkaq, drejtorja e shëndetit pasesor ka njoftuar qe të mos vazhdojnë me punimet pikerisht per arsye të ndotjes së ujit në keto vendburime.

Dilaver Xhelili

## Avokati i Popullit në Berat

Avokati i Popullit ka pritur dje në bashkinë e Beratit ankesa nga banorë të këtij qyteti. Kjo është një praktikë e zakonshme e Avokatit të Popullit. Ai vjen çdo vit në bashki për të marrë ankesat e shtetasve që nuk kanë mundësi që të udhëtojnë në Tiranë, apo të paraqesin ankimet me letra për arsye të ndryshme. Kanë qenë të shumta ankesat e paraqitura nga banorë të ndryshëm në pritjen e djeshme, por edhe sipas z. Hysa tre ish-in drejtimet më kryesore të ankesave: mostrajtimi nga pushteti vendor i të pastrehëve dhe sidomos i të ish-të persekutuarëve që janë pa banesa, apo janë nxjerrë nga banesat që kanë pronarë, ndërtime pa leje, të cilat lejohen nga bashkia dhe nuk ndërhyet nga policia e ndërtimit në lagje dhe për shërbimin jo të mirë të zyrës së përmbartimit dhe asaj të regjistrimit të pasurive.

Ankesa më specifike që është paraqitur para Avokatit të



Avokati i PopullitE. Dobjani

Popullit dje ka qenë nga një banor i Beratit për KESH-in, i cili mbledh pagesat me kamatë vonesa në një kohë që në qytete të tjerë arkëtimet nuk bëhen me kamatë vonesa. Fakti që KESH-i është ndërmarrje unike në tërë vendin dhe bën dallime në shitjen apo në pagesat për qytete e zona të veçanta përbën për qytetarin një mënyrë persekutimi dhe padrejtësi ligjore që cënon rëndë banorët e Lushnjes, Beratit, Kuçovës e Skraparit, të cilët edhe pse kanë nivelin më të lartë të arkëtimeve, kanë kufizime të shumta dhe paguajnë me kamatë vonesa ndryshe nga Tirana e qytete të tjerë.

## Aksident i rëndë në aksin Ura Vajguore -Syzez

Dy aksidente të njëpasnjëshme që kanë ndodhur në rrugën nacionale Berat -Lushnje, përfunduan me një të vdekur e tre të plagosur. Rreth orës 04.30, furgoni i mallrave me targë BR 46 14 A, që drejtohej nga R. Sh., lindur e banues në lagjen "Barrikada" të qytetit të Beratit, është përplasur me një karrocë që shkonte drejt pazarit të fshatit Poshnje. Ajo ishte e ngarkuar me bagëti dhe drejtohej nga 68 -vjeçari Osman Xhelo, banor i fshatit Banaj, i cili ka vdekur në vend. Kurse djali i tij, Estrefi, 18 vjeç, dhe drejtuesi i furgonit janë plagosur. I mituri ka plagë të rënda dhe i është thyer një këmbë, të cilën rrezikon ta humbasë fare. Drejtuesi i furgonit ka patur plagë më të lehta në trup, ai mori ndihmën e parë mjekësore në spital dhe rreth mesditës është dërguar në dhomat e shoqërimin të komisariatit të policisë së Beratit. Ndaj tij u vendos masa e ndalimit deri në sqarimin e plotë të rrethanave të aksidentit. Tre orë më pas është shënuar një tjetër aksident, në po të njëjtin vend, kur një makinë me targa të Tiranës, si pasojë e shpejtësisë së madhe dhe lagështirës në asfalt, doli nga rruga. Shoferi i saj mbeti i plagosur.

## Pezullohet nxjerrja e pllakave

### Tregtarët e gurit shkaktojnë ndotjen e burimit

Është arritur përfundimi për shkakun e ndotjes së burimit të ujit në Bogovë dhe janë parashikuar masat e para për të shmangur këtë ndotje, e cila gjithësesi nuk do të përjashtohet përfundimisht.

Grupi i ekspertëve gjeologë dhe hidrogjeologë si dhe ata të institutit të studimeve bërthamore kanë rekomanduar që të pezullohen punimet e nxjerrjes së gurit dekorativ në rreth 70 % të sipërfaqes, ku është punuar deri tani duke u zhvendosur nxjerrja e pllakave të gurit më në veri të shpatit të Malit Tomor. Burimet nga prefektura e Beratit kanë pohuar për gazetën "Lajmëtari" se 12 firmat e licensuara që kryenin aktivitet të ligjshëm në atë minierë preken nga ky vendim që pritet të merret nga qeveria, sepse harta e veprimtarisë së tyre parashikonte ato territore që tashmë janë rekomanduar si shkak i ndotjes së burimit që furnizon me ujë Poliçanin dhe Beratin nga ujësjellësi i vecantë i ndërtuar në Bogovë.

## Shqetësime nervore, vetëvritet 65-vjeçari nga Ura Vajguore

65- vjeçari S. Z. i dha fund jetës së tij mbrëmjen e së premtes, duke u hedhur nga kati i katërt i pallatit ku banonte. Sipas policisë, ngjarja ndodhi rreth orës 23.00. Një depresion nervor i çastit mendohet ta ketë shtyrë të moshuarin drejt aktit kriminal ndaj vetes. Ai përfundoi mbi bordurën e betontë, poshtë pallatit, me thyerje e plagë të shumta. 65-vjeçari vdiq rrugës për në spital.

I vetëvritari banonte vetëm me gruan e tij, pasi të gjithë fëmijët i kishte të martuar. Ajo kujdesej vazhdimisht për 65-vjeçarin, sepse ai kishte vazhdimisht shqetësime nervore, por me sa duket, nuk mundi ta ndalojë natën e së premtes që të merrte vendimin fatal.

## PROTESTOJNE TE SEMURET QË MARRIN ILAÇET ME RIMBURSIM

Te semuret që marrin ilaçe me rimbursim kanë protestuar për veprimet që po kryejnë farmacistet, për moskëzimet e medikamenteve me rimbursim. Pjesa më e madhe e pensionistëve që vuajnë nga tensioni, janë paraqitur pranë qendrave shëndetësore, për të kryer vizita. Për ta një ditë të mos marrin mjekim, do të thote shume.

Pa rimbursim pensionistët nuk i marrin dot ilaçet se janë të shtrenjta, kështu që i janë drejtuar spitalit për vizite. Por, mosdhenia e ilaçeve nga farmacistët ka ndodhur edhe në rrethin e Beratit, ku dhjetëra të semure janë paraqitur me receta në dore, por në fakt janë kthyer duarbosh. Farmacistët nuk kanë bërë ekzekutimin e recetave të leshuara nga mjekët e qendrave shëndetësore të qytetit. Behet e ditur se rreth 20 të semure kanë kërkuar ndihmën e spitalit si pasojë e mosmarrjes së ilaçeve.

Shume familjare kanë dhene alarmin pranë institucioneve të pushtetit vendor që të nderhyret pranë Ministrise se



Shëndetësisë për t'i dhene fund kesaj komedie, se po rrezikojnë jete njerezish.

"Nuk ia kemi borxh askujt që të tallen me të semuret, ky kontigjent njerezish është i pafajshëm", tha, Fatmir Troni, banor i Beratit.

Dilaver Xhelili

## RRESHQET DHEU, SHEMBEN 6 BANESA

Shkarja e dheut në lagjen "28 Nentori", të qytetit të Beratit, ka shkaktuar shembjen e 6 banesave. Shkaku i kesaj katastrofe për 6 familjet nga Berati, të cilat papritmas kanë mbetur në qiell të hapur, është lageshtia e madhe dhe prishja e mureve mbrojtës të ndërtuara vite me pare. Shembja papritmas e 6 banesave ka frikesuar jo vetem familjet "viktima", por edhe të gjithë banoret e kesaj lagjeje. Familjaret e demtuar shprehen se gjendja ishte bere e pranishme një vit me pare në bashkinë e qytetit ku dhe është kerkuar ndihma e saj për strehimin e tyre diku në një vend tjetër.

Meleq Paja, një nga të demtuarit, shprehet:

"Ne gjithmone kemi kerkuar ndihmën e bashkise për të marre masa paraprake për parandalimin e shkarjes se tokes, por kerkesat tona kanë rene në vesh të shurdhet. Neglizhenca e kesaj bashkie çoi në kete gjendje ku ne tashme ndodhemi në qiell të hapur".

Sipas familjeve të demtuara, një vit me pare në kete lagje kanë ardhur një grup specialistesh nga Instituti i Tiranës, të cilet, pasi kanë bere analizat e tokes, i kanë lene detyre bashkise se Beratit që të ndërtoje muret mbajtes dhe të eliminoje gropat e ujërave të zeza që kanë ndikuar në shkarjen e tokes.

Ndërsa burime nga bashkia bejne të ditur se ajo ka bere të pranishme gjendjen në zyrat e emergjences në Ministrinë e Brendshme, me datën 16 mars të ketij viti, ku ka kerkuar fonde për strehimin e ketyre 6 familjeve që tashme ndodhen në qell të hapur.

Dilaver Xhelili

## Takim për luftën kundër trafikut

Lufta kundër kultivuesëve të bimëve narkotike si dhe masat që duhen marrë për shpërndarjen e lëndëve narkotike në qarkun e Beratit ka zbritur dje në këtë qytet Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, z. Bajram Ibro, së bashku me Drejtorin e Decentralizimit në Ministrinë e

16 rrenjë bimësh të mbjella.

Njëkohësisht sipas drejtorit të policisë së qarkut të Beratit edhe përdoruesit e lëndëve narkotike tashmë furnizohen që nga Fieri gjë që e ka treguar arrestimi i tri grupeve të tilla brenda këtyre tri muajve të këtij viti, të cilët transportonin drogë që nga



Brendshme, z. Hysen Ismaili. Në një takim të zhvilluar për këtë qëllim në prefekturën e Beratit, pasi është njohur me krijimin e një shtabi pranë prefektit për të organizuar luftën kundër kultivimit dhe shpërndarjes së narkotikëve Ibro ka përgëzuar punën e bërë deri tani në Berat në këtë drejtim.

Sipas tij Berati nga një rajon i cili radhitej ndër më të parët në kultivimin dhe shpërndarjen e bimëve narkotike tashmë për vitin 2005 janë zbuluar vetëm dy vatra me

Fieri në Berat.

Ibraj ka folur edhe për arrestimin e të kërkuarve nga policia si dhe rezultatet e aritura në këtë drejtim deri tani.

Sipas tij, bashkëpunimi i strukturave të policisë së shtetit me homologët e tyre në shtete të tjera sa vjen dhe përmirësohet, ndaj u bëj thirrje personave të shpallur në kërkim që të vetëdorëzohen me qëllim përfitimin e masës së dënimit nga lehtësirat që u garanton ligji, sepse janë të arrestuar shpejt apo vonë, ka thënë Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit në Berat.

## Kundërshtohet zhvendosja e spitalit Obstetrik-Gjinekologjik

Sindikata kundërshton zhvendosjen e spitalit Obstetrik-Gjinekologjik që nga godina ku është tani në qendër të qytetit për në territorin dhe godinën e spitalit rajonal të Beratit. Megjithë vendimin e komunikuar nga Ministri i Shëndetësisë që brenda datës 15 Maj shërbimi obstetrik-gjinekologjik të transferohet në spitalin rajonal ku janë bërë rikostruksionet e mjediseve përkatëse, tashmë janë sindikalistët ata që kundërshtojnë një veprim të tillë të cilin më parë e bënin specialistët e atij shërbimi.

Sipas një peticioni të shkruar dhe që i është drejtuar znj. Jozefina Topalli, Kryeministrit Sali Berisha dhe Ministrit të Shëndetësisë Maksim Cikuli, federate e sindikatave të Beratit që drejtohet nga Loreta Ymeraj, nuk do të lejoj zhvendosjen e këtij shërbimi sipas urdhërimit të ministrit dhe ka kërkuar që të bëhen investime për të rikostruktuar godinën ekzistuese dhe të ngrihet një godinë e re për këtë shërbim në Berat.

Nga ana tjetër Drejtori i spitalit rajonal të Beratit, z. Mikail Miti, ka theksuar se shërbimi Obstetrik-Gjinekologjik do të transferohet në godinën e spitalit rajonal sepse investimet janë bërë dhe kushtet janë shumë të mira. Një gjë të tillë kanë pohuar edhe specialistët përkatës nga Ministria e Shëndetësisë të adhur disa herë më parë në Berat për këtë qëllim. Drejtues të shërbimit spitalor në Berat kanë theksuar për gazetën se ky kundërshtim tani i nxitur ka për qëllim që të fitojë kredo sindikata dhe drejtuesit e saj dhe të tregojnë se ekzistojnë e nuk paguhen kot së koti.

## Vidhet një dyqan para komisariatit të policisë

Vidhet edhe një dyqan tjetër në qendër të qytetit Berat. Ka disa javë që vjedhjet në qytet janë bërë dhe po bëhen shqetësuese për faktin se numri i tyre rritet ndërsa nuk është kapur asnjë autor së fundi.

Vjedhja e ndodhur rreth orës 22 e 30 të natës së djeshme ka qenë në dyqanin e shtetasit Gëzim Kaja, 33 vjeç në lagjen "30 vjetori". Shuma ka shkuar deri në një milionë lek. Vjedhja e bërë duke hapur qepenat dhe thyer derën në një orar të tillë, ka bërë përshtypje edhe për faktin se dyqani ndodhet shumë afër komisarariatit të policisë së Beratit.

# Bogova, burimi i rrezikuar

**A**naliza e specialisteve të thirrur enkas për të përcaktuar gjendjen reale të situatës në shpatin e Tomorit, përreth burimit të Bogoves, del komplekse, e përmbledhur, pasi vihet bashkë mendimi i të gjithë specialisteve.

Për të dhënë një informacion më të detajuar për lexuesit të ne, biseduam me disa prej specialisteve që ishin thirrur në çështje, si të institucioneve qendrore ashtu edhe me ata beratas.

E ndërsa bisedojmë me ta, vërejmë se nuk e kanë të lehtë të flasim, pasi ndiejnë presionin e madh përreth. Mendimet e tyre mund të vendosin fatin e një ekonomie të tere përveç fatit të ujit.

Ndiejnë se ecin në një fushe të minuar dhe çdo fjale që thone e peshojnë mire, ndaj, përpiqen t'i shpjegojnë gjerat thjesht nga ana teknike.

Gropat e hapura janë me siguri përgjegjëse, thone, e kjo s'vihet në dyshim. Ndotja është fizike e jo kimike dhe deri këtu del se janë të gjithë dakort.

Te gjithë mendojnë se zgjidhja më urgjente mund të jete vendosja e një filtri për pastrimin e tubullirave që me fjale të pakta janë dhëra në ujë.

Mendimet e tyre ndahen në masat që duhet të merren me tutje në kohë dhe kjo është normale, pasi secili e sheh nga pikpamja e vet.



nje valvul shkarkimi sigurie. Uji ndotet se para se të depertoje midis shtresave të pllakave gelqerore, prej dherave që gjenden në gropat e hapura.

pese vjetesh rregullisht themi të njëjtin mendim rreth shkaqeve të ndotjes.

Çarja mund të mbyllet si pasoje e tronditjeve mekanike, si plasma e tritolit ashtu edhe nga depertimi i dherave që çimentifikohen me guret që gdhenden përreth çarjeve e burimi mund edhe të humbasë.

## Thuhet se mjafton të ndalen karrierat

### aty afer burimit dhe problemi zgjidhet

E kam degjuar edhe une nga njeri prej specialisteve. Sigurisht zona afer burimit ka ndikimin më të madh, por e gjithë zona ujmbledhese, që është shumë e gjere, ndikon sipas meje.

E për të parë e bere gjerat më mire, mendoj, se duhet të ndalohet shfrytëzimi për të paktën një vit në të gjithë zonën. Me vonë mund të përcaktohet se cila pjesë ndikon më shumë e këtu duhet të thone të tyren edhe specialistet e fizikes berthamore.

### Ne të kundert çfare rrezikojmë?

Sot për sot problemi i ndotjes mund të zgjidhet me ane të një filtri, por pas një viti mund të mos mjaftojë më. Problemi nuk mund të shtyhet më. Në na therrasin prej

\*\*\*

Mendimi i specialisteve minerare, hidrologjike, atyre të mjedisit është se gropat duhet të ishin mbyllur menjehere pas shfrytëzimit.

“Në kemi vene re se gropat nuk janë mbyllur dhe në lejet e shfrytëzimit që firmat marrin përcaktohet se vendi pas shfrytëzimit duhet të rehabilitohet”, thote Anila Kal, shefe e agjencise rajonale të mjedisit

E kjo nuk ndodh.

Shumë prej firmave që kanë lejet e shfrytëzimit nuk e nxjerrin vetë gurin, por i marrin pllakat nga fshataret e zonës përreth, pasi këta të fundit shpeshherë s'te lenë të futesh në “token” e tyre

Aq më tepër fshataret s'mund të bëjnë rehabilitimin e firmat nuk mund të harxhojnë leke për gropat e hapura nga fshataret.

Agjencia rajonale e mjedisit që duhet të vëzhgojë për zbatimin më rigorozitet shfrytëzimin sipas kriterëve të përcaktuara në lejen e shfrytëzimit, e ka të vështirë ta bëjë punën e saj.

Me një personel prej tre vetash e një buxhet prej 10 000 lekesh sigurisht që s'ble dot as naftën për t'i vizituar të gjitha guroret e qarkut.

Agjencia kufizohet vetëm në dhenien e lejeve për aktivitetet me impakt të vogël mjedisor siç janë gropat e gelqerës e aktivitete të ngjashme.

Lejet jepen nga dy ministri, ajo e Ambientit dhe Ekonomisë, pas një studimi të kryer nga specialistet mbi impaktin që shfrytëzimi ka në mjedis e një plani të bere për rehabilitimin e mjedisit pas shfrytëzimit.

Në rastin konkret rezultatin në impaktin mjedisor e shohim jo vetëm në rubinetat e çesmave, por edhe në shtresën livadhore që humbasin përgjithmone, duke çuar në dizertifikimin e zonës.

Shfrytëzuesit s'mund të bëjnë rehabilitimin e mjedisit, pasi kjo kushton e askush deri më sot “s'u ka prishur punë”, përveç burimit që u turbullua.

Është e vështirë që ARM – ja në gjendjen që është të perballët me oreksin e shfrytëzuesve.

Tensioni që ndesh në fytyrat e specialisteve me ze në kapitull është i kuptueshem.

Dikush mendon se një fenomen që s'mund të kontrollohet duhet të ndalohet, e sigurisht për ata që duhet të bëjnë “policin” e ambientit kjo do të ishte zgjidhja

## Ja ç'doli nga biseda me zotën Aranit Gelaj, specialist i ujrave nentoksore

### Mund të na e shpjegoni fenomenin me fjale të thjeshta?

Uji i shirave deperton neper çarjet mes shtresave të pllakave e futet në çarjet tektonike nga ku me pas del në burime. Tomori ka disa burime të medha që janë grykederdhja e ujërave që dalin nga keto të çara.

Kur ka shira të medha mbi burimin e Bogoves del ujë edhe nga burimi pak më lart atij aktual, pra është si



# Braçe gënjen sot e gjithë ditën

Nuk mund të kuptohej kurrësesi që në krye të një gazete që ka 55 vjet që gënjen që nga mëngjesi e deri në darkë e që nga e marta deri të dielën, të caktohej ndonjë njeri që të kishte një fije sinqeriteti. Më i paturpshmi (nga ata që gënjejnë tërë ditën), më gënjeshtari, është ky çuni i nahijes sonë, që më shumë se sa deputet e politikan, të ngjason me ndonjë nga pjesëmarrësit e ndonjë festivali rroku, a pasarele mode. Nejse, ato janë qejfet e hobotë e tija. Fjalën e kemi te vesi i keq i të gënjerit. Nuk thonë më kot se gënjeshtria është nëna e tërë të këqijave. Këtë nënë të keqe, e ka zgjedhur për nënën e tij dhe çuni i i Braçajve. Nuk do të themi se si gënjen, e ia fut kot më kot. Ja ai thotë, Braçja nuk flet me emra, nuk përmend asnjë me emër, por ai thotë si burrat ama: "Një nga ministrat e Berishës...etj., etj.- Po se kush është ky ministër që na paska bërë namin këto 7 muaj e bilbilerët nuk qenkan ndier, një zot e di. Ndërsa pozita, si dje kur që në opozitë, kur ka akuzuar, ka akuzuar me emër e mbiemër, madje dhe babain në mes. P.sh., kur akuzonte Fatos Nanon, thoshte Fatos Thanas Nano, kur thoshte Edvin Rama, thoshte dhe emrin e babait të tij, Kristaqit, këtë e bënte që të mos ngatërrohej mileti me ndonjë Tos, Edvin, Iglu, Arben, e sa e sa të tjerë, që rastësisht mund ta kishin emrin njëllor, pa përfunduar as mbiemrin, që mbase për rastësi mund të ishte i njëjtë. Kurse, kryegënjeshtari i paçavures plakë, që nuk tha kurrë të vërtetën dhe tani gënjen kur na jep një intervistë në një lokale javore, në lidhje me masakrën që nuk ndaluan për tetë vjet me radhë, saqë sot kanë krijuar një precedent të rëndë e një katasrofë ekologjike natyrore në lidhje me shkatërrimin e një vendburimi uji (lexoni mirë UJI), që është gjëja

më e kërkuar sot në botë, ku nga mungesa e tij vdesin me miliona e përhapen lloj-lloj epidemish. Ne kemi një dhuratë nga Abaz Aliu i Tomorit, nga froni i Zotit dhe fëmijët e të pafeve, të atyre që prishën kisha e xhamija, që burgosën, torturuan e vranë me qindra e qindra jo vetëm klerikë, por dhe besimtarë, kërkuar të lënë pa ujë, jo pak por 120 mijë frymë njerëzish. Pa futur këtu dhe ata që janë embrione në barqet e nënave. Braçja thotë se, këtë masakër që po bëhej me burimin e Bogovës, jo vetëm kryeministrat si ai nga Skrapari, si ai nga Gjirokastra dhe ai korçari a kolonjari nga drejtin ishin, që të tre e dinin, por nuk mund të linin pa punë ja po themi 200 familje që ishin të tërë 10 000 frymë, që donin bukë, por rrezikonin të linin pa ujë 120 mijë banorë që lagnin buzët me ujin e Bogovës. Jo Braçe, jo, nuk ishte ky shkaku. Shkaku që se nuk hapët vende pune, si premtoi ai mjekër gjati, e jo mjekër vogli. Nuk kthyet lekët e vjedhura nga Farudin Arapi me kompani, nuk vutë në punë Poliçanin siç premtoat, por e grabitët duke ia shitur mbase dhe ti, një tjetër deputet po se po, por dhe një nëpunës i lartë lokal, pa harruar dhe një ministër e një kryeministër, që bënë lekë me armatimet që i shitnin vëllezërve kosovarë. Dhe, për të mbajtur frymën gjallë, e për të mos hapur gojën se ç'po bënit ju me Poliçanin, kur them ju, nuk e kam fjalën për ju i vogli Braçe, por për qeveritarët e zyrtarët tuaj, duke ju futur vendçe me dinamit e me bomba, mjete që sollën këtë gjendje që kemi sot. Ju nuk u thatë gjë, se po të mos nxirrnin pllaka ata, nuk kishte vota për ju. Ju mbyllët sytë e gojën, por dhe veshët, vetëm për të marrë herë vota për kryetarë bashkie, e herë për deputetë dhe i morët.

I morët dhe ujin burimit! Mirë se disa i latë vetë se gjoja ishin me leje e me liçensa. Po ata më të shumtit, të tjerët që punonin në mënyrë barbare, përse nuk i ndalonit? Kur i ndalonit një herë, përse kishin kurajo e rifillonin përsëri? Apo sepse ua zinin sytë ato 15-20% që merrnin nga nxjerrja e shitja e pllakave hajdutët e gurit dhe të ujit?



Erion Braçe

Mos gënjeni, e të thoni se kishit plane këtë vit, më 2006?! Përse pikërisht këtë vit që humbët zgjedhjet e jo një vit më përpara apo dy-tre vjet më parë? Ju e dinit se kishte dhe ka kosto, por ka dhe arsye dhe kontroll dhe ligj, por mos harro se ka dhe shtet, që ju nuk e kishit. Tetë vjet e radhë drejtuan si në qendër, si në bazë vetëm hajdutët. Tani Braçes, po na i ardhka keq për banorët që mbetën pa ujë! U pika keqardhjes së Braçes! Tani që pas hekurave është një ish-zyrtare e lartë e prefekturës, me siguri që do t'i vijë radha dhe pllakave të gurit "të flasin" e të tregojnë se kush e përse e lanë kaq gjatë e kush përfitoi e sa përfitoi nga kjo batërdi që iu bë burimit të kristaltë të Bogovës. Po të donte qeveria, më falni qeveritë, se socialistët ndërruan nja 5 qeveri, por nga rrokadat që bënin kryeministra hajdutët po në vend rrinin. Me ujin e Bogovës mund të furnizohej dhe Kuçova dhe Lushnja e deri në Durrës, mund të shkonte ai me vetërrjedhje, pa patur nevojë për pompa e energji elektrike. Këtë që nuk bëtë ju, do ta bëjë qeveria e djathtë, do ta bëjë, se ajo di të "rrezikojë" vota për shëndetin e qytetarëve. Sado që ju mundoheni të jepni shfaqje me bilbila e zhurrma, me pjesë të kompozura nga muzikanti i shquar Çim Hysa e Pilo Kërri, kjo qeveri do ta tejkalojë mandatin e vitit 2009, do ta tejkalojë se punët e mira duan kohë të bëhen. Prandaj, Braçe, nuk të beson njeri se ju do të merreshit ndonjëherë me këtë burim që desh e thatë, sepse oreksi për vota ju errësonte sytë.

Bujar Orizaj

# Ndërtimet pa leje po shtohen nga ditë më me zell

Ndërtimet pa leje nga ditë po shtohen, po mbijnë si kërpudhat pas shiut nëpër Berat. Zyra e urbanistikës merret vetëm me evidentimin dhe regjistrimin e tyre. Sikur të ishte kjo detyra e saj dhe e bashkisë.

Në mes të ditës po hidhen themele, po ngrihen ndërtesa, po zihen rrugët e planifikuara po nga urbanistika. E ç' nuk po bëhet?!



Flitet se policisë ndërtimore na i mungokan mjetet për prishjen e këtyre ndërtimeve. Duket që ajo pret **pandomat** të vijnë nga qeveria, që të jetë ajo përgjegjësjë e këtyre prishjeve.

Pse nuk ndalohen atëherë që në nisjen e themeleve? Nuk munden apo nuk duan? Hajde dhe gjeje!

Nëse përgjegjësi i urbanistikës nuk ka forcë, nuk do, apo ka frikë ta ngrejë zërin, apo..., le ta lërë atë vend pune. Nëse policia ndërtimore kërkon të mos e marrë mbi vete përgjegjësinë, edhe përgjegjësi i saj t'ia lërë vendin një më të guximshmi.

Si me PS-në në pushtet, si me PD-në ndërtimet pa leje nuk kanë patur dhe nuk kanë ndërprerje. Dhe kjo ndodh se policia ndërtimore në Berat ka prishur vetëm disa kioska pranë pazareve, ose ndonjë gardh pranë pallateve, kurse ndërtimet pa leje disa katëshe bëjnë karshillëk dhe me hijen e tyre po mbulojnë edhe ndërtimet e reja.

Berati është një qytet-muze, po kërkon të hyjë edhe në Unesco. Po me këtë pamje të shpërfytyruar kërkon të ruajë vlerat e veta?

I bëjmë thirrje prefektit të Beratit, z. Roland Bejko, si zëdhënës i qeverisë, që ta marrë këtë situatë në dorë, të ngrejë një grup kontrolli për t'i verifikuar këto ndërtime pa leje dhe ato që ende nuk janë përfunduar t'i ndalojë dhe t'i prishë dhe të kërkojë përgjegjësitë që duhet të mbajnë urbanistika dhe policia ndërtimore, si dhe të kërkojë nga qeveria që të ndërhyjë për ta mbrojtur qytetin tonë.

Agron Feriti

## Karrige për Bar- Restorante

C  
i  
l  
ë  
s  
i



tel: 036220295



interalbanian

PREKNI TE ARDHMEN

Drejtor Ilir Qepa

ADRESA:

AGJENSIA E AUTOBUZAVE  
PERBALLE XHAMISE SE PLUMBIT.

**K**a vite që paga e mesuesve është bere

thashethemnaja e dites, sa here që u behen premtime. Politikane, ministra, ish-ministra, opozitare, pozitare, aktore te humorit, shites zarzavatesh dhe ata te gabit, shto dhe gazetarë, te gjithë se bashku, thone nga nje fjale, duke qene kurioze, se sa do t'u rritet paga mesuesve. Per te ardhur te kjo e fundit, te rritja që premtonte qeveria Berisha. Fjale per fjale, programi i PD gjate fushates elektorale, nenvizonte "nje rritje 50% e rrogave te mesuesve, që ne dy vitet e para dhe dyfishimi i tyre vitin e katert". Pra, me fjale te tjera, kjo do te thoshte se mesuesve vit per vit, mbi pagën neto aktuale do kishte nje rritje prej 25%. Ky ishte premtimi i bere gjate fushates dhe duket se qeveria po kerkon me kembengulje ta mbaje ate. Mire, po a është ne gjendje ta realizoje nje gje te tille? Po te flisnim me shifra, a është ne gjendje që nje mesuesi, me vjetërsi mesatare, t'ia rrise pagën realisht me 5-6 mije leke te reja çdo vit? E theksojme rritje reale, sepse ka edhe rritje nominale, por nuk është rritje. Ne nje pjese jo te vogel te opinionit pedagogjik, por dhe me gjere, rritja e pagave te sivjetme per mesuesit ne sistemin parauniversitar, është cilesuar qesharake, e papranueshme. Eshte cilesuar si tallje zyrtare e rradhes. Edhe pse është folur pa pushim, nga te gjithë, akoma nuk dihet me saktësi se do jete 20%, 27% apo 17% kjo rritje. Ne kete perlllogaritje është futur dhe ashtuquajtura page e 13-te, te cilen mesuesit e marrin prej 5 vjetësh dhe qeveria e tanishme mendon se duhet shkrire gjate 12 muajve te vitit. Si ka mundësi që t'ua heqesh mesuesve diçka te cilen ata e kane fituar? Paga e 13-te ka statusin e nje shperblimi per çdo mesues te sistemit parauniversitar, e barabarte me nje page mujore neto, që duhet te jepet 2 here ne vit. Heqja e kesaj page, apo dhe shkrirja perben nje shkelje flagrante e ligjit mbi te cilen funksionon arsimi. Ne baze te kodit te punes ky shperblim ne masen e nje page neto nuk mund te hiqet me. Çdo vendim që prek pagën e 13-te nuk ka vlere, sepse vjen ne kundërshtim



ANASTAS PJETRI

me nenet perkatese te Kodit te Punes. Asnje lloj arsyetimi matematikor nuk e perligj kete veprim te keshiltareve te Kryeministrit, Ministrit te Financave apo kushdo qofte tjetër. Paga e 13-te, per te gjithë mesuesit që mbahen vetem me rrogen e shtetit, perben nje "ikone" ne te gjithë te ardhurat vjetore te tyre. Shumica e mesuesve e ruan kete page si syte e ballit. Nje pjese e perdor ne pushimet e dimrit dhe tjetren ne pushimet e veres. Edhe mesuesit kane te drejte dhe me se te nevojsheme te shkojne njehere ne plazh. Paga e mesuesve nuk është thjesht çeshtje matematikore, statistikore. Ajo është edhe politike. Por nuk mund te besh politik me aritmetike. Aq me shume te besh politike me aritmetike, me nje shtrese sociale që ne shumicen e tyre jane me shkollë te larte dhe nje pjese e tyre dine aritmetike dhe matematike me mire dhe me shume se ndonje keshilltar që qendron prane Kryeministrit. Mesuesit vertet jane nje shtrese e varfer, por aq gje e kuptojne se si po "rriten pagat". Ata e dine se çdo te thote buxhet i shtetit. Per nje buxhet si ky i vendit tone, fondi i pagave me zor sigurohet. Aq me teper kur është fjala per 20% e me shume se kaq dhe per nje numer mesuesish ne shifra te konsiderueshme, mundësia është e paperballueshme. Prandaj te rritesh pagën sipas premtimeve që ke bere, ne kushtet e vendit tone, do te thote ose te shkurtosh numurin e mesuesve, ose te besh rritjen ne nje kohe tjetër. Te mos perseritet i njejtë premtim i gabuar, bere nga qeveria socialiste per

# Paga e mesuesëve, politika dhe aritmetika

rritjen e pages 15%, vitin e fundit te mandatit te saj dhe që s'u be asgje. Problemi behet me i koklavitur me nismen që Ministria e Arsimit kerkon te beje me diferencimin e pagave mes mesuesve te lendeve te ndryshme, me saktësisht te lendeve natyrore dhe atyre shoqerore, per te vetmin shkak se gjithnje e me shume po ndihet mungesa ne rritje e mesuesve që japin matematike, fizike. Kjo është e vertetë, por a është kjo zgjidhja? Ashtu siç nuk është zgjidhje që te paguash me shume mesuesit e rinj se sa ata që kane vjetërsi pune. Per gjendjen ne te cilen është parauniversitarja shqiptare diferencime te tilla nuk jane as stimuluese, as edhe pjese e reformes ne sektorin delikat te arsimit. Ministri i Arsimit z Pollo ka shume te drejte kur thote se pas disa vjetëve nuk do te kete mesues që do japin lendet ekzakto. Gjendja është me alarmante se sa ajo që thote ministri. Studente që mbarojne per mesuesi dhe nuk duan te punojne mesues. Studente që mbarojne per pune sociale apo shkencë politike dhe nuk duan te japin sociologji dhe filozofi ne gjimnaze. Lenda e sociologjise dhe e filozofise ne nje numer te konsiderueshem shkollash te mesme është bere si lenda e punes me dru ne tetevjeçare. Gjithfare mesuesish e japin ate, jo te profilit. Nje ngarkese e tere

javore ne sociologji ndodh që "masakrohet" duke u ndare ne 4 apo me shume mesues jashte profilit. Pra, gjendja nuk është me e mire edhe ne lendet e tjera, jo natyrore. Sistemi parauniversitar ka nevojë vertet per diferencim ne paga, por menyra se si po behet, percipatzi, me njeanshmeri dhe vetem atje ku shfaqet e keqja, ka efekt diskriminues dhe aspak stimulus. Diferencimi ne paga duhet t'i sherbente konkurences ne arsim dhe jo ndarjes se nje grupi mesuesish nga nje tjetër. Edhe shtesa prej 1200 lekesh per mesuesit e matematikes, fizikes, informatikes, që mendohet t'u jepet nga 15 prilli është me se qesharake, s'ka nevojë shume per koment. 1200 -lekshi është thjesht nje kozmetike pedagogjike. Ne qofte se duam te bejme diferencim le ta fillojme kete mire, me rritjen e kesaj diference midis mesuesve që japin mesim ne tetevjeçare dhe atyre që japin ne shkollat e mesme te qytetit, me perparësi ne ato ku ka nivel cilesor. Diferenca aktuale ne paga është gati e paperfillshme. Ministria e Arsimit duhet ta dije se mesues me diploma universitare nuk preferojne te shkojne ne gjimnaze te japin mesim. Pse? Sepse perveç është resise se lendeve dhe problemeve që shfaqin 14-18 vjeçaret, paga që merret është gati e njejtë. Prandaj, nje diferencim i ndjeshem page o te bente

te zbutet edhe mungesa e mesuesve te shkencave natyrore aty ku nevoja është me e madhe. Mesues matematike dhe fizike duhen me perparësi ne gjimnaze se sa ne tetevjeçare. Diferencimi ne paga duhet pare ne raport me punen që ben. Duhet pare me sasine, cilesine dhe veshtiresine e saj. Paga është çmimi i punes. Pune te ndryshme kane çmime te ndryshme. E megjithate shperblimi i mesuesve per punen behet akoma ne menyre "kooperativiste". Te gjithë paguhen pothuajse njelloj. Si ai mesues që ka 23 ore ne jave dhe ai me 18 ore paguhen njelloj. Si ai që ka klase kujdestari dhe ai që s'ka perseri njelloj. Si ai që ka 1 pergatitje dhe ai që ka 2 apo 3, perseri njelloj. Si ai që vjen çdo dite ne pune dhe ai që e shtyn me raporte ose s'vjen fare ne pune perseri paguhen njelloj. Diferencimi është me imediat se kurre, por ai duhet te jete i pergjithshem, i prekshem, konkret, çdo muaj, sepse dhe paga është mujore. Perveç mungeses se diferencimit ne paga, aspekt tjetër jo produktiv, negativ ne arsimin parauniversitar ka qene keqmenaxhimi i burimeve njerezore. Shkolla shqiptare ka qene ndoshta istitucioni i shtetit, i tipit "han me shume porta" ku mund te vinte te punonte kushdo, kur te donte, te rrinte sa te donte dhe te largohej ne nje vend pune tjetër dhe te

kthehej perseri andej ku kishte ikur. Rotacionet politike te te gjitha ngjyrave i hapen dyert e te gjitha zyrtare te shtetit, per mesuesit. U mbushen plot e perplot bashkite, komunat, prefekturat, qarqet, taksat, tatimet, ministrite e te tjera e te tjera, me "profesioniste" që emrin e kishin mesues. Padyshim, e drejta e njeriut është e drejta e njeriut, por e mira e shtetit ka me teper vlere dhe rendesi se ajo e individit. Vetem ne Shqiperi ndodh ajo që shteti ja "futi vetvetes". Ne cilin vend te botes ndodh që brenda nje jave, nje mesues i lendeve natyrore le njeri pas tjetrit 3 vende pune? Ne cilin vend te botes ndodh që nje mesues po i lendeve natyrore, me deshire braktis vendin e punes dhe pas rotacionit kthehet titullar ne arsim. E te tjera e te tjera. E pra, mesues te lendeve natyrore perseri ka, por ne nuk po dime akoma t'i "perdorim ligjerisht". Le t'i hedhim nje sy statistikave se sa mesues punojne ne institucionet e tjera te shtetit, jashte sektorit te arsimit dhe do shikonim se shifra është serioze. Bashke me kete, le te shkojme se sa është numuri i personelit drejtues ne shkollat shqiptare, ne arsimin shqiptar dhe perseri do te na dukej luks i madh po ta krahasonim shifren me ato te vendeve te tjera. Pra, mesuesit ekzistojne. Nuk ka mesues që nuk punon, por varet nga menyra se si i menaxhon.

## Mos bini në grackë të alkoolit

**A**lkooli mund të sjellë kënaqësi kur pini me raste, por kjo mund të jetë fillimi i një tatëpjete të rrezikshme. Pirja e tepërt të çon në depresion, të shton sëmundjet, të shkakton deri dhe vdekjen. Ky është shpërblimi i alkoolit.

Pirja në mënyrë të vazhdueshme, quhet sëmundje e alkoolit. Rastet janë të shumta, që nga pirja e tepërt kanë pësuar aksidente dhe janë kthyer në invalidë.

Pirja e alkoolit është një emblemë me dy medalje. Në njërin anë të bën të gëzueshëm, tepër në humor kur je në një darkë apo tryezë miqësie dhe ai që s'e ka kaluar normën e pirjes dhe tjetra trishtimin për veten e tij, për të afërmit e tij që e rrethojnë.

Pirja e tepërt është helmim dhe ajo barazohet si një kafshim i gjarprit, pothuajse më keq se të çon në vdekje.

Sipas një statistikave të Ministrisë së

Shëndetësisë, aksidentet nga pirja e alkoolit zënë vendin e tretë nga drejtuesit e automjeteve, kryesisht nga të rinjtë e të rejtat që drejtojnë automjetin.

Alkooli është nxitës në dhunën në familje, të cilët i çon deri në vdekje. Pirja në këto stina të nxehta nga çdo grup moshe sjell rrezikshmëri nga të gjitha llojet e pijeve që përmbajnë përqindje alkooli.

Ja disa prej tyre:

50 gram raki është e barabartë me një gotë verë 200 gramëshe ose me 500 gram birra, në të cilat përqindja e alkoolit është e pakët, por të llogaritur me volum janë pothuajse të barabarta edhe në gradë pothuaj të barabartë. Kini kujdes, eliminoni tepërcat se edhe ushqimi i tepërt është i dëmshëm. Në këto stinë pijet alkoolike zëvendësojini me pije freskuese ose fruta edhe për gjininë femërore.

Josif Mio

Me autobusin e linjës Goriçan-Berat udhëtojmë bashkë me ish- teknikun e kanaleve dhe tarracimeve të mirënjohur Hasan Sula. Mjeti me të cilin kishim hipur çan mospërmas fushave të fshatrave Goriçan Qendër, Goriçan Çlirim dhe fshatrave më të mëdhenj në popullsi, Samaticë dhe Drenovicë. Bashkudhëtari im xha Hasani, kthente kokën sa majtas, djathtas ku shumë fermerë me mundin e tyre kanë mbjellë kultura të ndryshme për të mbajtur familjet. Ka pak ditë që ka rënë shi dhe shumë prej fushave ishin mbushur me ujë të bollshëm duke u dhënë prodhimeve zverdhje të dukshme. Vura re se i moshuari i shikonte me vëmendje të madhe dhe diçka e mundonte. Ia lexova mendimin në sy dhe si për t'u gjendur me të në bisedë, thyhej heshtjen:

- Ka marrë ca si tepër lagështi dhe vijat janë tejmbushur.

Nuk ktheu përgjigje për çastin. E kuptova se kisha hyrë hak tek i zoti.

- Por dhe njerëzit, sikur janë dembelosur, xha Hasani, aq sa dhe kokat e vijave nuk i kanë shkarkuar.

- Tani e gjete më thotë. Perëndia do të bëjë punën e saj, njerëzit të tyren.

Nuk e ngacmova, se më kishte zënë në grackë. Ai ka lënë 86 vite të jetës së tij dhe mbahet akoma. Ndoshta dikujt do t'i duket e çuditshme, por është i vetmi në fshatin tonë që shkruan bukur dhe lexon pa syze. Sa herë që më takon thotë. "Ke marrë ndonjë gazetë?" Dhe kur nuk më takon dërgon gruan e tij Adifen dhe unë përveç të përjavshmen "Lajmëtari", i jap dhe gazeta të tjera, pavarësisht datave. Siç tregon dhe vetë xha Hasani, është rritur jetim, sepse nëna e ka lënë të vogël qysh në vitin 1922 dhe për të, për shumë vite, filloi kalvari i vuajtjeve duke u rropatur në baltovinat e të pasurve duke nxjerrë me mundim bukën e gojës. Por jetimi, thotë ai, nuk ka fat. Kjo për shkak se dhe shërbimin ushtarak e kreu në Jugosllavi, bashkë me shokun e fëmijërisë, Qazim Vrapit dhe ky jetim, po nga nëna, një rastësi. Madje bashkë kanë si kujtim nga toka Jugosllave dhe një fotografi të zverdhur nga vitet që ata e quajnë të veçantë se kanë dalë me një ari, të cilin e kanë zënë në pyll të gjallë dhe e kanë futur në mes, ngritur në këmbë. Ka një dhunti të veçantë, sepse vjedhurazi gjatë kohës së rinisë së tij ka mësuar të shkruaj dhe të lexoj ndër miq në Ngurrëz të Lushnjës si dhe kontaktet e ndryshme që ka patur me njerëz me horizont të gjerë, si Muhamer Janina, Baki Velçani (Bistrovica) etj. Ka qenë një teknik i shkëlqyer i kanalizimeve, sistemimeve, e tarracimeve. Dhe si për t'i zgjuar kujtesën i lutem për të më treguar disa nga veprat që ai me shumë shokë të rretheve të ndryshme kanë dhënë kontributin e tyre.

Edhe pse i moshuar ai ka një mendje të kthjellët që rrallë gjen në moshë të tilla dhe siç thotë populli kjo është peshqesh për tipa të tillë. Ka marrë pjesë në bonifikimin e fushës së Myzeqesë, bërjen e rezervuarit të Murrizit (Thanës) afër Fier-Sheganit të Lushnjës, kanalet që tërheqin ujërat e tij, siç është ai i Çukasit dhe dëgëzimi tjetër po në funksion të rezervuarit të Murrizit, ose siç quhet ndryshe Kanali i Bedenit. Të dy këto kanale, në kohën e monizmit ujisnin gjithë fushën e Myzeqesë. Në këto vepra xha Hasani nuk lë pa përmendur dhe kontributin që kanë dhënë dhe specialistët sovjetikë dhe jugosllavë, sepse bëhet fjalë para vitit 1950! Xha Hasani nuk ka kryer ndonjë shkollë për gjeometër e teknik kanalesh, por dhuntia e natyrës, pasioni dhe shkolla e madhe e jetës, e cila bëri të mundur që ky njeri të fitojë titull, pa diplomë, çertifikatë, por titull popullor, nga masa e gjerë punonjëse për pesë dekada me radhë, që e thërrisnin teknik-gjeometër. Pra,

## Njerëz me një mentalitet ndryshe

Me teknikun 86 vjeçar goriçanas Hasan Sula



### Për një menazhim sa më të përshtatur të drurëve dekorativë

**K**rahas investimeve për ndërtime dhe restaurimin e rrugëve, trotuarëve dhe shesheve midis pallateve, një vend të rëndësishëm në këtë investim zë dhe gjelbërimi i këtyre mjedisve me drurë dekorativë, të cilët mbillen përgjatë rrugëve kryesore të qytetit dhe në parcelat e gjera të lulishteve, të cilat së bashku me lulet shumëngjyrëshe na krijojnë një mjedis mjaft të këndshëm e çlodhës.



Problemi që do të ngre në këtë shkrim është se jo të gjithë drurët janë të përshtatshëm për të ruajtur ekuilibrat e dëshiruar në harmoni me elementet e tjerë të infrastrukturës. Si fillim do të përmendja rrapet e rrugës në lagjen "30-vjetori" të cilët jo vetëm që trotuarin e kanë shkatërruar plotësisht, por edhe rrënjët e tyre janë bërë pengesë për kalimtarët, ndërsa trungjet e tyre po marrin përmasat e Rrapit të Velabishtit. Drurë të fisëm janë bliri dhe gështenja e egër, por ç'është e shtati i tyre brenda pak viteve po mbulon fasadat e pallateve ndërsa trungu dhe rrënjët e tyre po kërcënojnë me shkatërrim trotuarin ndërtimi i të cilëve është bërë me kosto të lartë, por që shenjat për një ndërhyrje të afërt janë bërë të dukshme në trotuarin para selisë së bashkisë.

Si qytetar, mendoj se druri i rrapit duhet hequr nga kultivimi si dru dekorativ dhe të zëvendësohet me drurë më të përshtatshëm për këtë punë. Kurse gështenja e egër dhe bliri, rrënjët dhe trungu i të cilëve dëmtojnë veprat e artit, të mbillen nëpër parcelat e gjera të lulishteve. Ndërsa në trotuar të mbillen ata drurë që kurora e trungut dhe rrënjët kanë një rritje të ngadaltë siç janë ligustra apo ndonjë pemë tjetër e ngjashme me, të cilat ruajnë një gjelbërim të përhershëm.

Kam mendimin se specialistët e kësaj fushe dhe ata që merren me menazhimin e këtij sektori, do ta vlerësojnë këtë shqetësim të ngritur nga një qytetar i thjeshtë.

Faleminderit për mirëkuptimin.

Enver Troka, ish-ndërtues në pension

ishin njerëzit ata që ia kishin dhënë këtë titull falë punës e përkushtimit të tij. Kalimtarët e shumë që udhëtojnë përmes fshatrave Agim, Kuç, Hinkë, Malas Breg, Goriçan, deri në Qafën e Sqepurit shohin brezaret, tarracat e shumta që janë projektuar dhe piketuar nga dora e këtij mjeshtri popullor, pa harruar sistemimet, e sa e sa hektarëve të ish-kooperativës së Goriçanit, kolektorëve, kanaleve, rrugëve, etj. Por mjeshtri i dekadave, është i pakënaqur kur shikon sot se të gjitha kanalet janë prishur, kur për ngritjen e tyre janë bërë miliona investime nga shteti monist dhe fushat sot janë kthyer në baltovina që i ngajjnë atyre të paraqlirimit. Dikur këto fusha, prodhonin me bollëk, shton xha Hasani, dhe sot, fermerët pretendojnë se nuk ka rendiment. Nuk ka si të ndodhë ndryshe, vazhdon ai. Sistemit bonifikues, iu bënë barbarizma si rrjedhojë e politikës së verbër, sepse u ndërta në kohën e monizmit. Nuk ndodhi kështu në shtetet e tjera. Kolektorët dhe kanalet kulluese dhe vaditëse, janë si arteriet e trupit, pa të cilat nuk jeton njeriu. Kështu është dhe me kanalizimet. Është e pafalshme që rezervat ujore për vaditjen e tokave ekzistojnë dhe në fakt nuk ujitet pse s'ka kanale. 480 ha është sipërfaqja e rezervuarit të Murrizit dhe fusha e Myzeqesë nuk vaditet, sepse nuk ka kanale, ose stacionet e pompimit nuk funksionojnë, pa bërë fjalë për rezervuarë të tjerë, si ai i Kurjanit, etj. Po si do të bëhen kulturat bujqësore, pa vaditje? Mund të gatuash, fjala vjen pilaf pa ujë? Ja, kështu është bujqësia. Xha Hasani nuk i fsheh rezervat që ka për interesimin e shteti për këto vitet që jemi mësuar t'i themi tranzicion. Madje ai nuk fsheh dhe talljet që janë bërë gjatë fushatave për fshatin, ku jeton mbi 65% e popullsisë. Ai shton se vërtet ka njerëz në emigracion, por një ditë ata do të kthehen në vendin e tyre dhe kërkojnë kushte për të punuar. Por, po nuk pati ujë për të vaditur kanale, sistemime të ndryshme ku ata do të rrisin mirëqenien e tyre, sikundër po ndodh me shumë të rinj që i janë përkushtuar punës me perimet e serave dhe sigurojnë goxha të ardhura. Ne i duam djemtë në shtëpi që të kujdesen dhe për ne pleqtë, sepse kemi sakrifikuar për rritjen e tyre me njëmijë mundime dhe sot duam t'i kemi pranë. Por ç'të bëjnë ata kur këtu nuk ka kushte për të punuar, kur plehrat, pesticidet, plasmasi vijnë nga jashtë dhe shiten me çmime të larta, pa përmendur farnat e cilësinë e tyre? Shteti që t'i ketë njerëzit e tij këtu duhet të vërë dorë për t'i siguruar të gjitha ato që përmenda më sipër në vendin e tij, për të pasuruar veten dhe jo botën. Kështu dhe prodhimet do t'i sigurojmë nga vendi dhe të freskëta, pa ngarkesa kimikatesh siç kam dëgjuar. Nëse furnizimin me prodhime bujqësore e blegtorale dhe fruta nuk do të sigurojmë vetë, dihet se nga importi prodhime të skaduara do të marrim, ose prodhime me zhvillim të avancuar, aq të dëmshme për organizmin e njeriut. Lopën e mirë nuk e nxjerr njeri në pazar. Ky është personazhi i shkrimit tonë, këta njerëz me vizion e mentalitet ndryshe, që gjithë kohën kanë sakrifikuar për një copë bukë dhe tashmë që vitet po i tradhetojnë një nga një, përsëri kanë merakun për të punuar dhe të japin këshilla. Ai që ka qëndruar indiferent gjatë këtyre viteve përballë realitetit, ka qenë shteti, i cili duhet dhe mund të krijojë hapësira për popullsinë e fshatit, i cili plotëson dhe nevojat e qytetit me prodhimet e tij.

Nezir Vrapit

Në qytetin tonë, nga shkollat me traditë përveç gjimnazit nga i cili kanë dalë me qindra specialistë të lartë, ka patur edhe pedagogjiken me konviktin e saj ku strehoheshin nxënës jo vetëm nga fshatrat e Beratit, por edhe nga Skarapari, Lushnja, Fieri, Durrësi dhe Kavaja, por edhe nga Gjirokastra e Saranda. Themelet klasike të mësimdhënies në vendin tonë u hodhën që me Normalen e Elbasanit, por edhe pedagogjika e qytetit tonë arriti të konsolidohej nga niveli i mësimdhënies, falë një stafi arsimor të kompletuar nga niveli shkencor, moral, edukativ e kulturor. Konsolidimi u arrit dhe nga pëzgjedhja e nxënësve që bëhej vit pas viti. Mund të përmend disa nga mësuesit e plejadës së viteve 60-të: Luçi Nushi, Nuri Borshi, Skënder Kameniku, Andon Sinjari, Burbuqe Shtrepi, Shpresa Dingo, Asllan Sula, Elsa Xinxo (Vakëflliu), Vangjel Papa, Pandeli Vakëflliu, Nexhmedin Shehu dhe shumë të tjerë. Personaliteti i tyre ishte një shembull i shkëlqyer i paraqitjes, i komunikimit dhe përgatitjes ditore. Nuk u panë mësues të përtyreshin në mjediset shkollore, as dhe duke pirë cigare. Këta mësues nuk ishin të pasur, por veshja e tyre ishte sa e thjeshtë, aq dhe e bukur. Figura e tyre ishte shembull për mësuesit e rinj që do të nxirrte ajo shkollë. Sikur të stononte sado pak sjellja e një nxënësi, do të përballej me thënien e mësuesëve: -Kështu sillet mësuesi dhe edukatori i ardhshëm?

Kjo ishte një nga arsytet që mësuesit e pedagogjikes tregoheshin të kujdesshëm si në veprim dhe në komunikim, duke kultivuar në këtë mënyrë subkoshiencën dhe autokontrollin. Një pjesë e mirë e stafit pedagogjik kishin mbaruar jashtë shtetit.

Një bum i madh nxënësish erdhi me ndërtimin e shkollës së re, sot gjimnazi "Babë Dudë Karbunara" në vitin 1959. Nëse viteve paraardhëse kishte vetëm nga një klasë për vit, më 1959 filluan shtatë paralele A, B, C, D, E, F, G, me nga 52 nxënës për çdo klasë. Seleksionimi filloi në fund të semestrit të parë ku u shua një klasë. Një klasë tjetër u mbyll në fund të vitit. Klasa e tretë u mbyll në fund të vitit të dytë. Dy vitet vazhduan me katër paralele ndërsa viti i katër nuk kishte më shuëm se 42 nxënës për klasë. Në qershor të 1963 u diplomuan 160 mësues të rinj. Siç shihet afërsisht një e treta e tyre arritën të afirmoheshin. Nuk duhet të harrojmë se në vitin e tretë tre nxënës përjashtohen nga shkolla se u panë të pinin nga një krikë birrë.

Këto masa drastike bënë që pedagogjika e qytetit tonë të konsolidohej si një shkollë me parametrat e një kolegji. Edhe pse kishte profil pedagogjik, me dhjetëra nxënës mbaruan shkollën e lartë për matematikë e fizikë.

Arritën të afirmohen poetë, si Xhevahir Spahiu dhe



## A trashëgon gjë pedagogjika nga tradita?

Adem Istrefi. Me dhjetëra nxënës profilohehin në aktivitete artistike-sportive. Askush nuk mund të mbaronte shkollën pa ditur të luante në mandolinë apo violinë. Në këtë fushë dhanë ndihmesën e tyre mësues, si Xhuljan Myzeqari, Ramiz Haznedari dhe Xhevdet Dervishi, të cilët arritën të ngrinin formacionin koral, i cili dallonte për nivelin e lartë të përgatitjes si dhe orkestrën e vogël me fizarmonikë, violinë, mandolinë, xhez dhe kitarë.

Nuk mund të lihet pa përmendur puna e madhe e mësuesit Agim Doko. I gjallë, i shkathët dhe kërkues. Drejtues i aftë i manifestimeve të shkollave. Një drejtues i shkëlqyer i lojërave me dorë, i gjimnastikës dhe atletikës, ndaj dhe kjo shkollë nxori sportistë të këtyre fushave. Me atë kontigjent nxënësish dhe mësuesish ishte lehtë të hapej fakulteti pedagogjik, i cili do të ishte nder për qytetin e lashtë.

Po shkolla pedagogjike sot? Mbledh nxënës nën mesataret, por më e keqja, ka nga ata që nuk dinë tabelën e shumëzimit. Nuk janë të aftë të riprodhojnë atë që sapo lexojnë. Nxënës, pra, që kalohen për mëshirë nga klasa e tetë dhe që përfundojnë në pedagogjike.

Bëri bujë, ca vjet më parë nga që një person kishte marrë para të madhe nga nxënësit që regjistronte në këtë shkollë. Kjo të bëhet e besueshme kur një prindi i thua se vajzën e ka të dobët, ndaj t'i futet një profesioni, ajo ta kthen:

"Mos u mërzi ti, veç po desh nxirrja notën mbi tetë, ta dijë për nder. Sa të jetë paraja, ia gjej vendin vajzës. Do ta çoj në pedagogjike"

Dhe me të vërtetë vajza sot është në pedagogjike. Kjo dukuri ndodh me të ardhurit nga fshati, të cilët me prona në fshat dhe dyqan në qytet ushtrojnë e diktojnë mitmarrjen vetëm të arrijnë qëllimet e tyre. Pikërisht, nga kjo kuptohet se nuk mund të bëhet fjalë për nivel shkencorë. Jo vetëm niveli shkencor, por dhe ai edukativ lë për të dëshiruar duke cituar si veshjen, sjelljen e komunikimin. Në fund të orës së gjashtë në bankat e tyre janë gjendur bishta cigaresh, kuti tualeti dhe më e papranueshmja në dyshejen e saj shihen lëvozhga farash dhe letra të grisura dhe kur u tërheq vëmendjen për këtë gjë as që duan t'ia dinë. A kërkohen norma të edukatës në atë shkollë? A mund të shpresosh që këta nxënës të bëhen edukatorë? Dikush mund të thotë: po pse i kalojnë mësuesit? Mësuesi do t'i kalojë, ndryshe do të ngelet vetë pa punë, por mundësi ka. Nxënësit të pranohen me konkurs ashtu siç po bën Medreseja e qytetit, e cila ka rritur cilësinë e pranimeve si dhe nivelin shkencor të nxënësve.

Uroj që këto konstatime të kuptohen mirë për të sjellë ndryshimet për mirë në këtë shkollë, e cila përgatit armatën e re të mësimdhënies dhe të edukatës. Kjo armatë do të përballet me kërkesa të reja shkencore dhe metodike dhe do të çojë shkollën tonë drejt shkollës së re evropiane.

Luftar Spahiu

## Ndalimi i duhanit në vende publike - si ndikon kjo fushatë në ritmet e pirjes së duhanit

**O** Në Calabasas, një qytezë e vogël pranë Los Angelosit, filloi të zbatohet një formë e rreptë e ndalimit të duhanit, më e rrepta deri tani në Amerikë. Kryetari i bashkisë së qytetit thotë se njerëzit nuk kanë fare të drejtë të pijnë duhan. Ndalimi i duhanit është pjesë e një prirjeje në rritje në Shtetet e Bashkuara dhe Evropë. Kjo prirje duket se po jep efekte në rënien e numrit të atyre që pijnë duhan si dhe në konsumin e cigareve.

Calabasasi është i fundit në më shumë se 2 mijë qytete amerikane që e kanë ndaluar duhanin, por ligji këtu është më i fortë se kudo – duhani ndalohet në të gjitha vendet publike, jashtë dhe brenda. Kryetari i bashkisë, Barry Groveman thotë se njerëzit kanë të drejtë të thithin ajër të pastër. "Nuk ekziston e drejta për të pirë duhan.

Ekziston e drejta e mbrojtjes së sigurisë publike," thotë ai.

Amanda Schwartz nuk është dakord. "Kjo është antikushetuese sepse njerëzit duhet të kenë të drejtë të bëjnë çfarë të duan përsa kohë që nuk dëmtojnë dikë tjetër."

Mbrojtësit e ndalimit të duhanit thonë se thithja e tymit të duhanit të të tjerëve dëmton ata që nuk e pijnë. Prandaj ndalimi i duhanit duket se po ndihmon në parandalimin e këtij dëmi. Në 2005-ën, shitjet e cigareve në Shtetet e Bashkuara ishin më të ultat në 55 vjet. Zyrtarët e shëndetësisë ia atribuojnë këtë rënie në pjesën më të madhe fushatave dhe politikave kundër duhanit.

Stanton Glantz është mjek në qendrën kërkimore për luftën kundër duhanit: "Kur e ndalon duhanin në punë, në vendet publike, në restorante dhe bare, njerëzit pijnë më pak dhe prandaj shiten më pak cigare."

Por a i bën ndalimi i duhanit njerëzit që ta lenë atë? Përgjigja duket të jetë, PO. Një numër studimesh tregojnë se ndalimi i duhanit i dekurajon fëmijët të fillojnë të

pijnë, ul numrin e cigareve që pijnë njerëzit çdo ditë dhe i bën njerëzit ta lenë duhanin.


David Spalding kishte 20 vjet që pinte duhan por e la atë kur punëdhënësi i tij, kompania e sigurimeve shëndetësore Blue Cross/Blue Shield në Minesota e ndaloi pirjen e duhanit përreth zyrave të saj. Ai thotë se nuk do ta kishte lënë duhanin po të mos ishin rregullat e reja që e ndalonin atë. "Nuk doja të merrja makinën për të shkuar diku ku mund të pija duhan. Kjo ishte e gjitha." Spalding nuk është i vetmi, sipas nënpresidentit të kompanisë Marc Manley. "Kur vendosëm këtë rregull, rreth 18 përqind e punonjësve pinin duhan. Pas një viti, niveli ra në 15 përqind," thotë z. Spalding. Prirja për të ndaluar duhanin është përhapur tani edhe në Evropë. Dy vjet më parë Irlanda vendosi ndalimin e duhanit në pabët legjendare të saj ndërsa Britania do të bëjë të njëjtën gjë së shpejti. Megjithatë numri i njerëzve që pijnë duhan në vendet e zhvilluara po bie, ai është në rritje në vendet në zhvillim. Duhani është shkaktari i dytë i vdekjeve në botë - prej tij vdesin rreth 5 milion njerëz në vit.

Amy Katz

### LIBRI

## VRIONASIT NDRYSHE

Është libri i parë me studime i përgjesësës së Muzeut Historik Marelë Guga. Në këtë libër hidhet dritë mbi një nga familjet e famshme shqiptare, atë të Vrionasve. Libri gjendet në libraritë e Beratit.



Në botë ka vend për të gjithë e secili si vjen ashtu edhe ikën duke lënë pas një emër, për mirë apo për keq, që nga emërtimi i shoqërisë dhe opinioni përcaktohet jetëgjatësia. Kur një njeri ndahet nga jeta i mirë apo i lig qoftë, të mbeturit pas nuk i kujtojnë ligësitë, por vetëm të mirat për të ruajtur një kujtim sa më të ngjizur për të ecur së bashku me gjithë paraardhësit e si për të hedhur pas krahëve ato bëma e prapësi që nuk duhet të kujtohen.

Njeriu i mirë i bën vend vetes në jetë e shoqëri me figurën morale, jetën e përkorë, punën, dashurinë e mirësinë shpirtërore, me dëshirën për të bërë e parë mirë e më mirë, me urtësi e në udhë të Zotit.

Një njeri nderon vetveten kur të gjithë e nderojnë, por më tepër kur ndahet nga jeta e pas lë vetëm kujtimet.

Sa herë afrohen festa apo ritualet fetare në familje apo midise publike e në shtëpitë e Zotit, qofshin kisha, xhami, teqe apo sinagoga përherë të pranishme në biseda janë figura që kanë lënë gjurmë në komunitet.

Shekujt kanë përcjellë dijetarë e teologë plot dinjitet ndër ne, por në këto vite të ringjalljes së fesë e theksoj në vendin tonë, pas një periudhe pauze e shkëputje nga feja, dinjitarët të vjetër apo të rinj, ashtu thjesht e pa bujë shpalosën vlerat e tyre duke u ekspozuar figura model për bashkëbesimtarët e gjithë sa i njohin.

Nderim e respekt të veçantë përcollim sa qe në jetë e më pas në kujtesë të të gjithëve At Vangjeli, i mirë, që ishte një me veten, golëmbël, fjalarti, zemërbardhi, shpirt njeriu. Me pak fjalë do ta quaja "nektari i klerikëve", etalon për brezat besimtarë e në veçanti për klerikët e të gjitha besimeve ndër ne.

Ndoshta për rastësi përkoi mëshimi i parë i tij pas shumë vite në kyç të dyerve të kishës, me hyrjen time për të parën herë në jetë në altarën e saj. Mbetet një ditë e shënuar për besimtarët ortodoksë beratas dhe gjithë të pranishmit për faktin se në këtë mision të parë pas kaq vitesh At Vangjel Xoxe do të shpaloste para të gjithëve fjalën e Zotit e për më tepër në prani të një kleriku në shkallë superiore, kryetarit të kishës autoqefale Ortodokse të Bostonit, të përndriturit At Artur Liolin.

Në mes ndriçimit kishëtar e midisit në pritje plot ankth, me një qetësi të

# I përkori

Në kujtim të At Vangjel Xoxes

habitshme dhe të admirueshme priste sekondë pas sekonde fillimin e ceremonisë.

Në çaste të tilla tepër emocionale humbasin fjalët e më tepër flasin shikimet në heshtje e sekondat duken vite në pritje për të gjithë të pranishmit.

Një provë është një masë vlerësimi për këdo e sidomos kur të bie për hise të jesh para besimtarëve të çfarëdo besimi qofshin.

Më takoi ta uroja i pari se një hap larg njëri-tjetrit ishim në këto çaste e të them të drejtën instiktivisht i theva të gjitha rregullat fetare, i dhashë dorën me shikim të përqendruar drejt e në sy, e përqafova dhe urova me gjithë zemër.

Emocione të dukshme e të forta, një përqaftim mëse vëllazëror edhe pse ishim të besimeve të ndryshme, pika loti që pezullonin si margaritarë nën thyerjen e rrezeve të dritave pranë meshëtarit. Dikujt do t'i duket nostalgji, ndonjë tjetri dukuri dobësie. E vërteta shpërthen si rrezja e diellit e nuk ka ndalesë para çfarëdolloj barriere. Zemrat i flasin në heshtje njëra-tjetrës pa qenë nevoja të shprehin me zë atë që shpalosin aq sinqerisht sa vështirë të kuptohet atë që ndiejnë e përcjellin me gjithë sinqeritetin e çiltërsinë shpirtërore.

Zëri i tij melodioz, i butë kadife mbeti i

përtjetuar në mjediset e kishës së Shën Spiridhonit e u rrënjos për të jetuar shumë gjatë te të pranishmit.

Urimi i bërë nga Kryepeshkopi Liolin ishte një balsam për zemrat e gjithë besimtarëve dhe mbeti si një përmendore e skalitur në kujtesën e gjithë të pranishmëve që e përcjellin të freskët

nga viti në vit, sa herë bie fjala në të tilla tema. Pastërti e shpirtit, pastërti e mendjes, pastërti e jetës, figurë e stampuar e që secili do ta lakmonte. Në rugë, në kishë apo në familje, njeriu i Zotit, me të drejtë thonë, është një me Zotin, me fjalën e tij në gojë e përkorësinë në kompleksitetin e figurës së klerikut. I drejtë si vetë drejtësia.

Besimi për misionarin shpirtëror mbetet alfa detyrimi moral për ta përçarë besimin në Zot te të gjithë pavarësisht nga mosha, niveli kulturor apo pozita shoqërore mbetet një udhë e gjatë dhe e vështirë për t'u përshkuar.

E për këtë klerik e njeri të përkorë të gjithë e me gjithë zemër flasin: "I ndritë shpirti atje ku prehet!".

Të tillë njerëz lindin pak, jetojnë pak në këtë jetë e lënë memorie të pashkruar që rron shumë gjatë në emër të komunitetit në përgjithësi e të besimtarëve në veçanti, pavarësisht kanë patur ose jo funksione të larta në hierarkinë klerikale të të gjitha besimeve.

Në këto ditë festive përcillet ky kujtim një mal me lule mbi pranverën e jetës së tij e fjala të shpërthejë si përherë, plot admirim, nderim e respekt për njerëz që vend për herë i bëjnë vetes mes njerëzve ku jetojnë e punojnë.

Namik Gjoni



## FTESE PER OFERTE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DREJTORIA RAJONALE E MONUMENTEVETË KULTURËS

*Drejtoria Rajonale e Monumenteve të Kulturës Berat me fondin limit prej 280 000 mijë lekë të financuara nga buxheti i shtetit kërkon oferta për:*

"Blerje karburanti (Gazoil) D1

\*Forma e procedurës së prokurimit tendër - kërkesë për kuotim.

\*Kërkohet që shërbimet të kryhen në Berat.

\*Ofertuesit e interesuar mund të inspektojnë dokumentat e tenderit në zyrën e prokurimeve të kësaj drejtorie me adresën lagjia "28 Nëntori", pranë Xhamisë Mbret, me nr. tel. 032 32 300.

\*Një kopje e plotë e dokumentave të tenderit mund të blihen nga kandidatët e interesuar me anë të një kërkesë me shkrim drejtuar entit prokurues dhe pagesën e një tarife të pakthyeshme prej 500 lekë.

\*Ofertat duhet të dërgohen te Drejtoria Rajonale e Monumenteve të Kulturës Berat.

\*Afati i fundit për dorëzimin e ofertave është data 15.05.2006 ora 12. Ofertat e dorëzuara pas këtij afati do të refuzohen.

\*Ofertat duhet të shoqërohen nga dokumentat ligjore dhe administrative origjinale ose kopje të noterizuara si provë e kërkesave kualifikuese të përaktuara në dokumentat e tenderit.

\*Sigurimi i ofertës në shumën prej 5600 lekë duhet të dorëzohet së bashku me ofertën. Format e pranueshme të ofertës janë përcaktuar në dokumentat e tenderit.

\*Kontraktuesi është i përjashtuar nga prokurimi i mallrave, shërbimeve ose ndërtimeve që mund të pasojnë, si rezultat i ose në lidhje me këtë kontratë.

\*Asnjë ofertë nuk do të përjashtohet nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit në bazë të shtetësisë.

\*Ofertat do të hapen në Drejtorinë Rajonale të Monumenteve të Kulturës Berat në datën 15.05.2006, ora 12.

\*Përfaqësuesit e ofertuesve janë ftuar të ndjekin hapjen e ofertave

Drejtori Ajet Nallbani

RR  
Ë  
F  
E  
NJ  
Ë

## Baba Qazimi të ngrin

Baba Qazimi, në krahinën tonë mbahej si shenj. Gjithçka që ai thoshte merreshin nga njerëzit si të vërteta të pakundërshtueshme, qofshin ato edhe më absurdet.

Një herë ishte ftuar për darkë në një shtëpi në fshatin ku kishte teqenë. Si zakonisht në atë darkë mbledheshin edhe fqinjët për nder të Babait që të dëgjonin ndonjë fjalë të vyer nga ai.

Babai nisi të tregojë gjithfarë historirash nga më të pabesueshme, të paraqitura këto si të vërteta dhe se kush i kundërshtonte do të ndëshkohej me mallkim nga Zoti dhe në rastin më të rëndë nga ai vetë.

Mirëpo në atë darkë ishte edhe një djalë i ri, i cili kundërshtoi ato që thoshte Babai, sepse iu dukën absurde. Babai që s'ishte mësuar me kundërshtime, iu drejtua djalit dhe e kërcënoi se do ta ngrinte e do ta bënte kallëp.

Të pranishmit u tmerruan dhe iu drejtuan Babait që ta falte dhe t'ia bënte kabull ato që tha se e kishte nga axhamillëku.

Mirëpo babai mori zjarr më shumë dhe tha se kushdo që do të kundërshtonte, do të kishte fatin që ai i premtoi djalit.

Djali i ri, i cili nuk i hante dot ato dokrra, i tha Babait që ta ngrinte, se edhe ai nuk donte më jetë dhe këtë ta bënte në çast. Këtu ngeci Babai, sepse në të vërtetë ai e dinte që s'mund t'i bënte dot asgjë djaloshit dhe për të dalë nga situata i tha:

- Meqënëse se ti djalë dashke të ngrish, unë nga inati yt s'po të ngrij.

Bardhyl Myftiu

“Mund ta gjykos një vend nga mënyra se si i trajton kafshët”,

Gandi

**K** ishte kohë që kishte hyrë në vëmendjen e qytetit. Sidomos të rinjtë e shikonin me admirim dhe zili. Jeta e tij ishte një kureshtje për të gjithë ata që merreshin me llafet e qytetit.

Ishte një burrë që sapo i ka kaluar të dyzetat. Tepër i pashëm, inteligjent, krenar, i shoqërueshëm me të gjithë, zemërgjerë dhe mikpritës. I martuar me gruan që dashuronte. Kishte një djalë të vetëm, shumë të edukuar dhe tepër punëtor. I kishte ecur mbarë kurbeti. Ishte kamarier në një nga lokalet më në zë të Athinës. Të atin e ndihmonte me të gjitha mundësitë që kishte.

Kishte një fermë që u siguronte të gjitha nevojat familjare. Ai e administronte për bukuri. Kishte njohuri të mjaftueshme për bujqësinë. Merakosesh së tepërmi për sigurimin e bazës ushqimore për kalin e tij. Kjo ishte pika më e dobët e tij. E shoqja ndonjëherë për humor i thoshte: Unë nuk e di se kë do më shumë, mua, kalin apo qenin. Ai e përqafohte e i thoshte: të tre njëllonj. Ata jo vetëm i dua, por i kam edhe shokë të ngushtë. Ne jemi rritur bashkë, bashkë me ata ne bëhemi tre, e di atë këngën “Ne jemi tre”?

Ai kishte të drejtë ta donte atë. Gjoku e thërriste.

Sapo e ëma e kishte lindur, kishte ngordhur. Problem mëzi. Ai kishte lindur i bukur.

- Nuk e lë të ngordhë,- tha ai.

E pastroi dhe mblodhi me batanije leshi që të mos mbërdhinte. Mori qumësht të vakët në një shishe me biberon dhe ia vuri në gojë. Për çudi ai filloi ta pinte me kënaqësi të madhe. Ky ritual vazhdoi deri sa e rritën dhe ai filloi të hajë bar dhe tagji. Gjoku u bë pjesëtar i familjes, them kështu se ngado që vinin ata, ai ishte prapa. Kur e thërrisnin, ai vinte me vrap dhe lozte me ta. Ai i mësoi Gjokut shumë fjalë: Hajde, ik, ulu, shko në kasolle, ngriu përjetë, hajde se do të ikim të kullosim, etj. Ata merreshin vesh me njëri-tjetrin për bukuri. Gjoku u rrit dhe u bë një kalë shumë i bukur dhe besnik, por të bezdiste me atë që donte të ishte në shoqëri me të zotët e shtëpisë. Kujdesja për të ishte e madhe. Ushqimi i zgjedhur, plus një pastërti që edhe njerëzit do ta kishin zili, çdo mëngjes do të kashaisesh, do laheshin këmbët me ujë të ngrohtë dhe të fashoheshin, pastaj fillonte mësimi. Ai e mësoi të ecte bukur, të mësohej me shalën që do t'i vihesh në kurriz edhe të tërhiqte kaloshinën e bukur që kishte blerë.

Vizitat në qytet ishin mbresëlënëse. Hipur në kaloshinë me atë kalë të bukur kalonte rrugëve të qytetit. Ai kishte një pamje kalorsiake që sfidonte veturat lluksoze të çunave të qejflinjët, të cilët jo vetëm që s'e kishin inat, përkundrazi e përshëndesnin duke i rënë borijeve plot gëzim... Ata e dinin që kishte një zemër të madhe plot mirësi, por dinin edhe dobësinë që ai kishte për kafshët. Kush do kafshët, do Zotin.

Kur shkante në qytet gjithmonë e

pinte kafënë në ato klube ku mund të parkonte kaloshinën e tij. Policët jo rrallëherë e kanë gjobitur, por më vonë i bëri miqë se edhe ata i kishin qejf kuajtë.

Një ditë u nis herët në qytet. Por pa kaluar shumë kohë, mbërriti përsëri në shtëpi. E shoqja u habit kur e pa.

- Të lutem më ndihmo. Këtu kam një qen që e ka shtypur makina. Mos më shiko ashtu. E gjeta në rrugë të braktisur,

zinte vendin e të zotit në kaloshinë dhe e ruante atë.

Dani ishte krenar për qenin e tij. Shokët që ia dinin këtë dobësi një ditë i punuan një rreng: kishin gjetur një qen të madh dhe e ndërshyen kundra Klinti.

- Dani bërtiti me të madhe: “Mosni se do ta mbysi. Ai nuk do ta falë, në të tilla raste bëhet shumë i egër.

- Po kush dëgjonte! Shfaqja filloi. U grumbulluan shumë kureshtarë. Ishte një

sëmundje. Megjithatë janë ngjarje ku përfshihen njerëzit që të japin një gjykim të saktë për ta...

Një gjë ishte e qartë: Ai ishte i sigurt për tokën ku shkelte.

Pak rëndësi kishte rezultati që arrinte në një punë, rëndësi kishte që ai të jepte më të mirën nga vetja e tij. Ai ishte njeri i veprimit.

Hygo ka thënë: “Nuk mjafton që njeriu të jetë i lumtur, ai duhet të jetë i

# Ata ishin tre!



ka nevojë për mjekim se ndryshe ka për të ngordhur.

- Edhe këtë kishim mangut. Mjera unë për ty, ore burrë. Pse nuk u bërë veteriner dhe gjithë të jetën merresh me kafshët, më mirë mos martoheshe.

- Nuk të vjen gjynah? Shiko si dridhet. Bjemë ujë të ngrohtë dhe fasho. Ta shikoje në fytyrë ai sa s'qante. Gruaja e dinte dobësinë që ai kishte për kafshët, prandaj vrapoi për t'i prurë ato që ai kërkoi për mjekim.

Ajo kot që bënte llafe, edhe ajo ashtu si ai do të kishte vepruar.

Dashurinë për kafshët ai ia kishte futur në gjak.

Ai qen e mori veten shpejt. Ushqimi i zgjedhur dhe ilaçet e bënë efektin me njëherë. U miqësua me të zotët e shtëpisë bile edhe me Gjokun u bë shok. Në grazhdë flinin afër njëri-tjetrit. Kur Gjoku kulloshte në livadh, ai i rrinte gjithmonë pranë. Ti shikoje kur vraponin të dy. Ja pra edhe kafshët paskan nevojë për shoqëri... Jetokan në shoqëri me njëri-tjetrin, pavarësisht që s'janë të një lloji.

- Po njerëzit pse grinden, pse vriten e gjakosen për asgjë? Ata ndryshojnë nga pamja: Gjoku i bardhë, ndërsa Klinti (kështu quhej qeni), i zi, i madh dhe i fortë. Ishte i racës dobërman.

Ata të tre formonin një ansambël të vogël: Kali i bardhë, kaloshina e bardhë, i zoti veshur me kostum të bardhë, ndërsa qeni i tij sterrë i zi. Gjithmonë kur shkante në qytet dhe ai zbriste për t'u takuar me shokët Klinti

përleshje për jetë a vdekje midis dy qenëve. Ajo nuk mund të vazhdonte gjatë. Klinti brenda pak minutave e vuri poshtë duke i mbërthyer gurrmazin. U dëgjua një kuisje e llahtarshme e qenit tjetër që po jepte shpirt. Ishte për të ardhur keq, por asgjë s'mund ta shpëtonte. Klinti ishte bërë bishë.

- Jua thashë që kështu do të përfundonte,-u tha Dani.

Klinti mbasi mbaroi punë me kundërshtarin, hipi në kaloshinë dhe po priste të zotin dhe të tre u nisën për rrugë.

Gjatë gjithë rrugës Dani e përgëzoi qenin e tij që s'e kishte turpëruar atje në qytet para gjithë atyre njerëzve. Sa mbërriti në shtëpi e lau qenin me shampo dhe i bëri një inxheksion kundër tërbimit. I pastroi plagët dhe ia mjekoi ato, pastaj e vuri në shtratin e tij dhe e mbuloi me një batanie. Ai i lëpinte duart gjatë gjithë kohës. Sigurisht edhe kafshët dinë të shfaqin mirënjohje.

Ajo që ndodhi në qytet mori dhenë. Dani dhe qeni i tij në qendër të vëmendjes. Një televizion vendor shkoi në shtëpi për t'i marrë një intervistë, por ai nuk pranoi.

- Ishte një budallallëk,- i tha gazetares, nuk duhet t'i armiqësojmë kafshët. Më erdhi keq për sa ndohi. Nuk ia fal vetes!

Ndenji shumë kohë pa shkuar në qytet. Aty ndodhin shumë gjera, të cilat bëjnë që të harrohen ato të mëparshmet... Duhet t'i ruhemi trishtimit. Ai është një ves shumë i keq që shpesh i bashkangjitet njeriut në ëastet e jetës së tij. Dani kishte një ndjeshmëri të tepërt karshi kafshëve të shtëpisë. Rrezik kjo t'i kthehej në

kënaqur.” Dani e ndjente kënaqësinë e jetës e këtë ia falte edhe të tjerëve.

Punët e mendimet e dobishme që njeriu lë pas mbeten të pavdekshme. Cilido qoftë, duhet të jetojë me djersën e ballit dhe vetëm këtu qëndron kuptimi dhe qëllimi i jetës së tij, lumturia dhe entuziasmi i tij...

Vorbulla e jetës shpesh e përfshinte Danin dhe pa dashjen e tij e vinin në qendër të vëmendjes së të tjerëve.

Një ditë vere, nga ato më të nxehtat, së bashku me kalin e qenin vendosi të qetësohej në hijen e një peme që kishte në livadh. Nga lodhja e kishte zënë një gjumë i thellë. Papritmas nga pema po zbriste ngadalë një nëpërkë e madhe. Ajo po drejtohej drejt kokës së tij. Rreziku i bëri që të zgjohej. Hapi sytë dhe u tmerrua kur pa sipër kokës nëpërkën. Nuk lëvizti megjithëse zemra sa s'po i pëllciste.

Klinti e pa edhe ai atë nëpërkë dhe në të dhjetat e sekondës iu hodh dhe e rrëzoi nga pema. E kapi nga qafa me dhëmbë dhe e vërtiti tutje.

Sikur ta kishin bërë me fjalë Gjoku u ngrit kasë përjetë dhe e shkeli nëpërkën me këmbë. Ata e shpëtuan të zotin. Mos i duaj pastaj kafshët!

Nga të katër anët i erdhën urimet që shpëtoi për mrekulli.

Njerëzit që nuk duan kafshët, janë të aftë për çdo gjë.

Refat Lapardhaja

# Romët e Pashallisë

Elham PASHA

**K**isha dëgjuar për romët e Pashallisë, por s'dija asgjë për jetën e tyre private. Në interes të enciklopedisë së bashkisë të Urës Vajgurore, që unë po e përgatis për botim, m'u desh të njoh me hollësi edhe jetën, punën dhe botën shpirtërore të këtij komuniteti interesant romësh. Në mjediset e tyre, përmes zhurmës gazmore, grumbullova shënime sa për një cikël reportazhesh, por në këtë shkrim do të ravijëzoj pak fakte vetëm rreth traditës së tyre.

Është hera e parë që unë futem me nuanca intime në një mjedis romësh. Habitesh totalisht me zhdërvjelltësinë dhe antihipokrizinë e tyre, mbi të gjitha me magjinë e botës së tyre intime. Tek mjediset e tyre zbulon lloj-lloj subjekte e motive, që nga lashtësia cigane deri në shartimet shqiptare. Është fatkeqësi për ne që s'e njohim këtë botë rome, me drita e ngjyra të ndezura.

Tani them me plot gojën se poeti i madh spanjoll Gracia Lorca paska patur të drejtë kur këndon poetikisht: "Josheni me pangopësi diellin në sytë e ciganëve".

Në fshatin Pashalli të Urës Vajgurore jeton një komunitet i vogël romësh. Këto familje kanë ardhur nga komuniteti rom i Moravës në fillim të vitit 1961. Komuniteti romë i Pashallisë nuk vjen nga romët endacakë, por janë romë nga komuniteti i romëve shqiptarë me pronë e vlera historike e

shpirtërore shekullore. Pra, janë një komunitet që kanë punën e tyre tepër të vlerësuar në mjediset e Pashallisë dhe zonave përfaqë.

Ky komunitet përbëhet nga këto fise: Shima, Kazanxhiu, Myrteli, Rakipi e Selimi. Romët e Pashallisë janë të

integruar plotësisht në jetën sociale dhe shoqërore të këtij fshati. Ata gëzojnë pronë si gjithë bashkësia tjetër e këtij komuniteti. Pothuajse të gjitha familjet rome jetojnë në shtëpi të reja, të ndërtuara me vetë kontributet e punës së tyre. Gjithashtu ata jetojnë në harmoni me familjet e tjera të Pashallisë e më gjerë.



Romët e Pashallisë i përkasin fesë islame dhe përveç festave të Bajramit, Vitit të Ri dhe Ditës së Verës, ata festojnë edhe festën e Shën Gjergjit. Ata, këtë festë me rituale pagane, e quajnë festën më të madhe të komunitetit të tyre. Atë ditë feste romët vishen dhe stolisen bukur. Fëmijët dhe të rinjtë stolisen edhe me kurora lulesh. Atmosfera rome në ritualin e Shën Gjergjit është vetëm gëzim, lodra, këngë dhe valle. Gjithashtu romët e Pashallisë festojnë edhe festën e Shellazores, një ritual autokton rom, e cila vazhdon një javë rresht. Ritualet e kësaj feste kanë të bëjnë me folklorin e tyre, veçanërisht të grave rome. Për shtatë ditë rresht gratë rome, me në krye këngëtarët dhe valltarët më të

mira të komunitetit të tyre, dalin nëpër fshat e më tej, duke interpretuar këngë e valle të ndryshme, në gjuhën rome dhe shqip. Nga ky ritual gratë rome përfitojnë edhe dhurata të ndryshme nga klientela e mjedisit ku ato zbulojnë folklorin dhe etnografinë e tyre.

Ja disa vargje e një valle të kënduar në ditët e shellazores rome: "Hapma derën qumështore-o, se jam e bukur por si ti. S' dua nuse për djalin- o...., vij për këngë e dashuri"

Romët e Pashallisë ashtu si dhe komuniteti i mirënjohur i romëve të Moravës, janë një komunitet i civilizuar mbi rrafshet sociale dhe historike të botës shqiptare. Në familjet e tyre ata kanë futur veshjen dhe mënyrën e jetesës autoktone shqiptare dhe më tej. Mbi të gjitha janë apasionantë dhe adaptues të kulturës dhe traditës shqiptare, veçanërisht të folklorit. Gjithashtu, bëjnë përpjekje për arsimimin e fëmijëve të tyre. Shumë vite më parë Pashallia ka patur një orkestrinë popullore të mirënjohur në hapësirat e Mesit të Urave, e përbërë nga romët e Pashallisë, si:

klarinetisti Qemal Shima, violinisti Petref Myrteli, dajrexhiu Sefe Myrteli dhe llahutisti Islam Kazanxhiu. Jo pak të njohura kanë qenë edhe këngëtarët rome, Behije Shima, Bukurie Kazanxhiu dhe Fatushe Myrteli, veçanërisht në ritualin e Shellazores rome.

Ndonëse shumë gjëra të romët e Pashallisë janë shqiptarizuar, veçanërisht veshja, gjuha e të parëve të tyre ende ruhet me fanatizëm, e cila po me këtë risi transmetohet dhe te fëmijët e tyre.

Gjithashtu, ata ruajnë shumë elementë të folklorit të tyre, veçanërisht këngët, të cilat i interpretojnë në gjuhën rome dhe shqip.

Në brezin e ri të këngëtarëve dhe instrumentistëve të rinj romë të Pashallisë bënë pjesë edhe këngëtarit dhe dajrexhiu Tomor Kazanxhiu. Ai ka grumbulluar dhe interpreton dhe shumë këngë rome, herë me nuanca epike dhe herë me elemente të theksuara lirike.

Familjet rome të Halit Shimës, Halil Kazanxhiu, Flamur Selimi, Arben Rakipi, në aspektin social dhe shoqëror s'i dallon dot nga komuniteti tjetër i Pashallisë.

## Mësojani shqipen fëmijëve

U mbush një vit që kur u ndava me mbesën time të vogël 10-vjeçare Pamela dhe nipin Geri.

Kur motra ime Veneranda dhe burri i saj Gëzimi, bashkë me dy fëmijët u larguan nga Tirana për arsye ekonomike në vitin 1997, djali ishte 7 vjeç dhe vajza 1 vjeçe.

Kishim një kohë shumë të gjatë, malli na kishte marrë.

Ajo banon në Pire të Greqisë. Fëmijët e saj ruajnë më së miri gjuhën shqipe. Greqishten e kanë mësuar me gramatikë.

Si motra dhe kunati gjatë këtyre viteve u tregonin se në Tiranë kanë të afërm dhe në Berat gjithashtu. Por s'e kisha fjalën këtu, por gjetkë, te dashuria për njerëzit në përgjithësi, zakonet, këngët, flamurin e Shqipërinë. Kur motra mbërriti në Berat me vajzën dhe djalin, u takuam e u përqafoam me një dashuri e mall sikur t'i njihnin prej kohësh, por ç'ka se banonin në vend të huaj prej 9 vitesh.

Kur u mblodhëm në tavolinë, vajza e vogël Pamela më pyeti:

- Daja të gjithë ata njerëz që erdhën e na takuan, kushërinj i kemi ne?

- Pse?- e pyeta unë dhe vura buzën në gaz.

- Mamaja më ka thënë se kemi vetëm 4 daja në Berat.

Vajza e gëzuar nga përqafoimet e shumta dhe nga pritja, iu kthye së ëmës:

- Të gjithë kushërinj i kemi ne ata?

- Jo,- ia pret e ëma,- janë miq e komshinjë të dajës, por për respektin tonë erdhën dhe na takuan.



Vajza ia priti me zë të lartë:

- Po ata flasin të gjithë shqip mama, janë edhe kushërinjtë e mi. O sa shumë që është fisi i mamasë!

I prekur nga fjalët e Pamelës së vogël, por edhe i mallëngjyer që mbesa ime gjeti këtu në Berat shumë ngrohtësi, e përqafoj me shumë ngrohtësi, e përqafoj me shumë mall duke i shpjeguar se vetëm në Berat ruhet akoma tradita që kur vjen një i larguar vijnë, na takojnë, na thërresin për vizita, që do të thotë na presin e na përcjellin me dashuri.

Vajza na befaso. Ky qenka Berati me këta njerëz të mrekullueshëm që të gjithë

ngjajnë sikur janë fis.

- Pse në Tiranë, kur ishim te halla, s'kishte shumë shqiptarë?

Të gjithë qeshëm, por edhe u krenuam se ne në Berat ruajmë dashuri me njëri-tjetrin, me fqinjën, mikun, shokun.

10 ditët që fëmijët e motrës qëndruan në Berat, u kënaqën me TV "Onufrin", TV "Kuçovën". Ata e vizituan qytetin e mamasë së tyre dhe me mbresa shumë të bukura u larguan nga qyteti-muze duke shpresuar se një ditë do të ktheheshin sërish.

Pavarësisht se fëmijët e motrës e flisnin mirë shqipen, kishin mangësira

historike për atdheun e tyre të dashur. Iu luta motrës që të mos pushojë që t'ju tregojë fëmijëve ç'është Berati, ç'është dashuria për Shqipërinë se jemi pjellë e kësaj toke.

I lutem të gjithë atyre nënave e baballarëve që janë në emigrim t'ia kultivojnë gjuhën e bukur shqipe, doket, zakonet, këngët e bukura bertase. I përmallur që të shihemi së shpejti, por edhe krenar se kam një nip e një mbesë inteligjentë, në tabelë nderi në shkollë atje ku jetojnë, hallall qumështi i nënës që i rriti, hallall toka shqiptare që prindërit e Pamelës dhe Gerit i përgatiti.


I shoqërova në Kala, vizituan "Onufrin". I tregova për 40 kishat. Mbas vizitave të shumta që bëmë, u shplohëm në bar "Mangalemi" te Porta e Pashait dhe aty ne u ftuam për të ndjekur grupin e këngës popullore beratase nga shoqata Antipatrea.

Gjatë koncertit mbesa dhe nipi thanë se një koncert të tillë e kishin parë edhe në Greqi, por në gjuhën greke.

- Po të kishte tavolina të mbushura do ta quaja dasmë të vërtetë se të gjithë kënduat ju dhe ne premtojmë se do t'i mësojmë këngët tona shqiptare. Kanali TV "Onufri" na pëlqeu shumë me programin e tij dhe TV "Kuçova" me koncertet rinore,- tha Geri 16- vjeçar. - Ju daja, pse nuk paguat biletën?- pyeti Pamela.

- Daja është anëtar i shoqatës "Antipatrea", që do të thotë vëllazërimi i Beratit në shekuj.

Josif Mio



Kulla e Bajrakut (e Flamurit)

Ajet NALLBANI

# Berati, kronika e jetës qytetare

## Shekulli XVIII

### Viti 1703

Valiu i Rumelisë urdhëron qeveritarët e krahinës së Beratit që të përgatisnin ushqime, meqenëse ai do të bënte shetitje në atë krahinë. Në krahinat ku nuk shkonte, mblidhej një taksë në të holla..., por kjo nuk ishte e gjitha. Kështu në taksat e rënda që shlyente popullsia e qytetit të Beratit, përfshiheshin edhe shpenzimet për rindërtimin e urës së qytetit...

### Viti 1715

Sanxhaku i Vlorës i thoshte banorëve të Beratit: "Në rast se nuk vini e bëni roje në kalanë e Vlorës me familjet e fëmijët deri në moshën shtatë vjeç, duhet të më jepni patjetër tetë a nëntë qese me akçe..., sipas një llogarie për një hane (10 shtëpi të zakonshme).

### Viti 1715

I drejtohet kadiut të Beratit dhe naibit të Mallakastrës një urdhëresë për vjelja e detyrimeve kontribut për fshatëria raja të Përmetit dhe Tepelenës që u ngrit për mos pagimin e taksave. Kundër tyre u dërguan esnafet e Beratit, të cilët kishin detyrë mbrojtjen e këtyre zonave. Dy vjet më

vonë shpërtheu kryengritja edhe në krahinat e Beratit dhe Mallakastrës, të cilat nuk paguanin taksën "ndihmë në kohë lufte".

### Viti 1735

Pjesa dermue e banoreve të Beratit, por edhe të Vlores dhe krahinat përreth, e lëshuan fenë ortodokse dhe kaluan në fenë islame. Zgjerimi i metejshëm i fesë së re nuk u prit kudo pa reagim. Një nga ormat e qëndresës ndaj fesë së re ishte dhe **krishterimi i fshehtë** (kriptokristianizmi). Krishterimi i fshehte përfaqësonte një gjendje kalimtare dybesimi përmes të cilit individë të krishterë e pranonin islamën vetëm formalisht, me qellim që të shmangnin pagesën e taksës së xhizjes (haraçit), dhe të gëzonin barazinë me popullsinë myslimane në jetën shoqerore. Ndërsa në publik këta paraqiteshin si myslimanë që mbanin emra të sferës islamike ..., në familje fshehtas ushtronin ritet krishtere.

### Viti 1738

Në krahinen e Beratit numëroheshin 100 çifligje relativisht të vegjël. Të dhëna më të sakta deri në këtë kohë, për shtrirjen e çifligjeve, kishte vetëm rrethi i Beratit. Në vitin 1701 kishte 166 fshatra dhe në 59 prej tyre kishte çifligje.

### Viti 1760

Shumica e popullsisë kristiane po kthehej në fenë myslimane. Në vitin 1760 (?) Ismail Pasha donte ta zhvendoste qendrën e Beratit në Velabisht, por hasi rezistencën e popullit të Beratit, që u ngrit dhe e vrau në rezidencën e tij (sipas historisë Ismail Pasha vritet në Vlorë). Vendin e tij e zuri qehajai i tij Ahmet Kurt Pasha.

### Viti 1760

Rilulëzimin e fundit qyteti e jetoi në periudhën e pashallëqeve të mëdha shqiptare. Ahmet Kurt Pasha dhe Ali Pashë Tepelena rirforcuan muret duke i pajisur me frëngji të shumta për pushkë... E vetmja veçanti që e dallon kalanë e Beratit prej të tjerave është muri tunel dhe rrethimi i dyfishhtë i qytezës me karakter mbrojtës.

### Viti 1770

Rreth kësaj date është ndërtuar Ura e Hasan Beut (Ura Vajgurore), nga Kurt Pasha.

### Viti 1798

Sipas Quevill, F.C.H.I., 1798, 1799, 1800 dhe 1801, në "Udhëtim në More, për në Kostandinopojë, në Shqipëri dhe në shumë pjesë të tjera të Perandorisë Otomane", thuhet: "Nga i lartëpërmenduri Andrea Mollosaku, Despot, u lindën tre bij dhe dy bija. I pari që lindi e pati emrin Zot Gjini, i dyti Zot Theodhori dhe i treti Zot Stoja. Nga të dy bijat, e para e kishte emrin Zonja Komita Muzaka, e dyta Zonja Kirana. Të parit që lindi, Zot Gjini Muzakës, ai i la të gjithë pjesën e shtetit, veç Beratit, Myzeqesë dhe Kosturit. Të dytit, Zot Theodhorit, i la Beratin dhe Myzeqenë dhe të tredit Zot Stojës, i la Kosturin ose, Kastorjen, me të gjithë fshtrat dhe domenet..." Autori radhit sundimtarët e Beratit: Bajram Pashën, Ismail Pashë Velabishtin, Ahmet Kurt Pashën. Pas vdekjes së këtij të fundit më 1784, i cili la të birin Mehmetin dhe vajzën e martuar me Ibrahim bej Vlorën, Mehmeti zuri këmbën e të atit, por Ibrahim bej Vlora mbas tre vjetësh e detyroi të abdikoj dhe mori vetë sundimin e Beratit, i njohur nga Porta e Lartë ligjërisht si Pasha. Në vazhdim autori e lartëson pashanë e Beratit, Kurt Pashën, si njeri human dhe i drejtë dhe lavdëron veprat e mëdha të ndërtuara në Berat nën kujdesin e tij, për të cilat kujtohet me respekt.

### Viti 1798

Ibrahim Pasha fton në Berat të vëllanë Mahmut Beun dhe e vret, për qëllimin e vetëm që të bashkonte distriktin e Vlorës me Beratin nën sundimin e tij. Vlonjatët, të zemëruar për këtë akt kriminal dhe të shtytuar dhe nga Ali Pashë Tepelena tashmë i emëruar pasha në Janinë, përgatitën sulmin ndaj Ibrahim Pashës.

## Shekulli XVIII

Ahmet Kurt Pasha ka ndërtuar Urën e Kuçit mbi lumin Seman.

## Shekulli XVIII

Urën e Hasan Beut, e ndërtuar nga Kurt Pasha, e rikonstruktioi dhe e mirëmbajti Hasan beu.

## Shekulli XVIII

Në qytetet tona ruhet një pasuri e madhe në lëmin e banesës popullore. Ajo i përket kryesisht shekullit XIX dhe në pjesën më të vogël shekullit XVIII. Vlerat më të mëdha i ruajnë qytetet-muze të Gjirokastrës dhe të Bera-tit.

## Shekulli XVIII

Ky shekull shënon periudhën e lulëzimit të përgjithshëm të ekonomisë feudale në vëndin tonë, e cila shprehet në sistemin e esnafëve. Çdo lagje e banuar tashmë kishte dhe qendrën e vet me xhami, çeçma, hamame, kompleksin e dyqaneve, etj.

## Shekulli XVIII

Në të gjitha kishat e Myzeqesë deri në Berat janë futur elemente të marra nga qyteti antik i Apollonisë, bile edhe për sarajet e pashait të Beratit janë marrë 70 qerre me gurë.

## Shekulli XVIII

Ndërrimi i fesë në këto zona ka qenë i vrullshëm në fund të shekullit XVIII, kryesisht vullnetarë.

## Shekulli XVIII

Në shumë qytete pati një farë rënie të zhvillimit, numri i zejeve përkundrazi u shtua. Kështu në Berat pothuajse ishin zhvilluar të gjitha llojet e zejeve që njiheshin në qytetet kryesore, si lëkurëregjës, mëndafshpunu-es, përpunues lëkurash, nallbanë, biçakçinjë, argjendarë, farkëtarë, bukëpjekës, kafexhinj, muratorë, qiripunues, bojaxhinj, shajakpunues, bozaxhinj, etj.... Përpunimi i lëkurave zinte vendin e parë, mbasi kërkohesh shumë si nga tregu i brendshëm, ashtu dhe i jashtëm. Zejet e zburimit, duke qenë se ishin përdorim të një pjese të shoqërisë, prodhimi ishte më i vogël, kështu shpesh ai kufizohej brenda qyteteve ku punohej me motive vendore.

## Shekulli XVIII

Në Selanik gjendeshin rreth 4000 zejtarë shqiptarë. Ndërtuesit shqiptarë, si ata të ujës-jellsave, çeçmave, shatërvanëve dhe të kalldrëmeve, ushronin veprimtarinë e tyre në Stamboll dhe në qytete të tjera. Që nga shekulli XVII Berati kishte 2000 shtëpi me 30 lagje. Shtëpitë e thjeshta përdhese me gurë, qerpiç, apo me derrasa, tregonin nivelin e ulët ekonomik dhe kulturor. Por nuk mu-ngonin dhe shtëpi dykatëshe, me oborre që u përkisnin të pasurve, funksionarëve të administratës turke si dhe godina publike, faltore elegante myslimane, si xhami, teqe, etj.

Luftë (imadi seferije), për llogari të valiut të Rumelisë... Dokumenti që hedh dritë drejtpërdrejt mbi tokat shqiptare, është një regjistër i ndarjes së kësaj takse midis fshatrave të kazasë së Beratit për llogari të viteve 1675-1676 (1086 hixhri). Prej kësaj periudhe dokumentacioni bëhet i vazhdueshëm deri në fillim të shekullit XIX. Ashtu si për sursatin, dokumentimi i vonët nuk do të thotë se kjo taksë ka filluar të zbatohet vetëm në mesin e shekullit XVII.

# E papritura

## Në kujtim të Vexhi Buharasë

Namik Selmani

I ardhur nga shumë larg profesori iranian, pasi do të vizitonte muzetë e shumtë të Tiranës, kishte marrë vesh nga organizatorët se do të vizitonte një qytet të vogël, diku në Jug, që quhej Berat. Që pa shkua në Berat, kishte dëgjuar disa copëza mendimesh, vlerash historike e kulturore të këtij qyteti. Ashtu si bëjnë gjithmonë të mençurit, para se të shkojnë në një vend të ri, edhe ai kishte “gërmuar” aq sa kishte mundur për të. Diçka edhe kishte shkruar në skedat e shkencëtarit. I kishin dhënë edhe një përkthyes me vete, një mezburrë me ca thinja të para që i kishin dalë në flokë.

Tirana i pëlqeu. Njerëz të varfër, por edhe të urtë. Pas ca ditësh të qëndrimit në këtë kryeqytet, i thanë se do të shkonin në Berat. Që në vizitat e para i lindi kureshtja për qytetin që priste ta vizitonte pas pak ditësh. Në Berat mbërriti në mbrëmje dhe u vendos në një nga hotelet e pakët të qytetit. Nga ballkoni i hotelit shihte diellin që binte në Shpirag me atë lojë dritash që i kujtonin paksa qytetet arabe që i kishte vizituar disa herë. U gëzua më shumë kur diellin e pa në mëngjes të lindëte nga Tomori. Një lumë që quhej Osum, lahej nën rrezet e diellit të vjeshtës beratase. Në Kala iu duk vetja edhe më i ri se ç’ ishte... Kishte hyrë edhe në Xhaminë Mbret, ku iu duk vetja se ishte princi më i ri i këtij qytetit.

Që në orët e para të ditës u nis për tek muzeu i qytetit që quhej ndryshe edhe një bashkim muzeshë. Aty kishte histori, etnografi, folklor, arkeologji... Muzeu ndodhej në zemër të lagjes kaq të çuditshme siç ishte Mangalemi. Kishte dy kate dhe donte pak kohë që ta vizitonte. Që në stendat e para u gjallërua. Kishte parë piramida, muze të shumtë, por edhe lashtësia e këtij qyteti e befasoi. Asnjëherë, që nga dita e parë e ardhjes në Shqipëri, përkthyesi nuk ishte lodhur sa në këtë muze. Në këtë paradite tetori ai kishte me të vërtetë shumë punë për të ushqyer kureshtjen e madhe të vizitorit.

Që një ditë më parë për vizitën ishte njoftuar edhe Vexhi Buharaja, i cili ishte bashkëpunëtor i jashtëm i muzeut. Ishin vitet 60 e , kur vinte ndonjë i huaj, edhe si historian, edhe si njohës i disa gjuhëve të huaja, Vexhiu i shoqëronte vizitorët, qofshin në grupe apo edhe të vetëm. E njihte pëllëmbë për pëllëmbë dhe e donte kaq shumë këtë qytet. Dinte t’ia deshifronte çdo gur e çdo pllakë. Po dinte edhe t’i këndonte me poezi, siç kishte bërë që më 1940 kur fitoi

edhe çmimin e parë kombëtar duke i kënduar bukurive natyrore e shpirtërore të Beratit.

Rregulli ishte i prerë. Cicëronët duhet të flisnin shqip e vetëm përkthyesi i autorizuar mund të komunikonte me vizitorin e huaj, kushdo që ai të ishte. Kështu me hap të ngadaltë, me vemendjen e një shkencëtari hulumtues, profesori i ardhur nga larg, shikonte stendat, prekte ndonjë objekt të lashtë, shënonte në një bllok të bukur e të vogël, dëgjonte... Tek fliste, Vexhiu i gëzohej fjalës shqipe që i hapte dritare të reja këtij profesori, të cilit nuk ia njihte ende vlerat e tij të vërteta. Nuk ishte detyra e tij. Po një gëzim tjetër e buronte së brendshmi. Të gjithë brezat e familjes së tij në vite e shekuj kishin folur persishten, si krua ujjëmbël. Të gjithë ata që nuk jetonin më, sikur bënin garë nëpër kohëra se kush ta fliste e ta shkruante më mirë edhe këtë gjuhë të vjetër.


E ..ja tani, pas kaq kohësh, përpara kishte një vizitor, një persishtfolës, duke i dhënë jo vetëm kënaqësinë e artikutimit të saj, por edhe duke i mallit për të parët e tij...

Në pavionin e fundit, kur vizita ishte në të mbaruar, Vexhiu i drejtohet përkthyesit: - Ju lutem, a mund të flas pak persisht me profesorin? Përkthyesi, duke e quajtur si një gjë tepër të rëndomtë kërkesën e këtij cicëroni që nuk e kishte njohur më parë, pranoi menjëherë. Këtë gjë ia tha edhe profesorit.

Së pari Vexhiu i tregoi diçka për mbiemrin e tij Buharaja që vinte nga shekujt, nga troje që vizitori i kishte njohur dhe i prekte çdo ditë. I bëri një historik tjetër të shkurtër të këtij qyteti, që, për nga mosha, mund t’ia kalonte edhe qyteteve arabe me famë. Në gjuhën e vendit të largët ai i tregoi për poetët, teologët, ndërtuesit, këngëtarët popullore, qëndistaret...

Profesori, tepër i matur deri në atë moment, nisi ta shikonte më ndryshe në sy. Gati i shtangur. I mrekulluar. I befasuar. Nuk ishte e vështirë që t’ia shikoje këtë gjendje të veçantë emocionale në fytyrë, në duart që mbanin bllokun e shënimeve. Nuk po shkruante më. Emocionet e kishin “mundur” ritin e shkencëtarit. E mundën protokollin zyrtar. Filloi të fliste edhe ai. I tregoi diçka për veten. Për detyrat që kishte.. Nuk kishte nevojë që të shihte një tjetër burrë në sy, me padurimin se si do t’ia besonte fjalën që ai do t’ia përcillte të tjerëve në mënyrën e vet... Më në fund i thotë:

- Faleminderit, miku im, që më tregove kaq shumë gjëra të bukura që paska qyteti yt! Më vjen shumë mirë që në këtë qytet që s’e kisha parë asnjëherë në jetën time, takova një njeri që e folka kaq mirë e kaq bukur gjuhën e kombit tim, gjuhën e të parëve të mi... Po më vjen keq, shumë keq dhe ndihem pak i turpëruar që ju e



Vexhi Buharaja

flisni kaq mirë atë sa ma kaloni edhe mua. Po, po, edhe unë nuk di që ta flas më mirë se ju këtë gjuhë.

Një çast u përqaftuan. Si miq të vjetër e të rinj. Gati të përqaftuar dolën duke zbritur shkallët më me ngadalë se i kishin ngjitur.

... Për të dy, por edhe për përkthyesin e ardhur nga kryeqyteti shqiptar, Berati kishte marrë një pamje më të

bukur, më të ngrohtë. Asnjëri nuk e pa orën se kur kishin dalë nga ajo ndërtesë që quhej “Muze”. Profesorit në çast iu kujtua përsëri xhamia që e kishte parë ditën e parë të mbërritjes. Quhej Xhamia Mbret. Jo, mendoi ai. I gjithë ky qytet me këtë bukuri, këtë lashtësi e me këta njerëz kaq të mençur, duhej të quhej në të gjithë kohërat “ QYTET MBRET”.

## Qilimi i nusërisë

A të mëngjes Mariana u ngrit herët. Të ftohtit kishte rënë. Doli në oborr të merrte freskinë e asaj dite të re dhe të bukur fillim muaji. Pa me gëzim bajamen. Ajo ishte mbushur e gjitha me lule.

- Paska ardhur pranvera!- tha me vete dhe u zhyt në përjetimet e kësaj stine.

Dikur quhej stina e mblesërive. Se me çeljen e bajameve, mblesërit fillonin të trokisin nëpër dyert e vajzave për t’i hapur rrugë vjeshtës së dasmave.

Jorgji, i vëllai, e pa ashtu tek qëndronte në mes të oborrit dhe, i shqetësuar, e pyeti:

- Ç’po mendon, Mariana?

- Asgjë. Veç në këto çaste nuk e di sesi më erdhi ndër mend historia e Nikës dhe e vajzës së saj, që kanë banuar në lagjen tonë, një rrugicë më tej, vite e vite më parë. E kam dëgjuar nga nënë Angelina. Edhe ajo e kishte të dëgjuar në të ri të saj nga e vjehrra.

- E ç’histori na qenka kjo që të qenka ngulur kaq thellë në kujtesë dhe që duhej të vine ky mëngjes pranvere që ta rizgjonte?

- Kjo ngjarje lidhet me një fejesë. Ki durim dhe dëgjoje...

...

Nika kishte një vajzë që sa vinte, rritej e zbukurohej. Ajo e shihte nga ditë me shqetësim. I trembej trokitjes së mblesit në derë se ende nuk e kishte nisur endjen e qilimit të nusërisë, pa të cilin asqë mund të mendohej fejesa e së bijës.

Për t’ia plotësuar së bijës këtë detyrim të domosdoshëm, kishte nisur dora-dorës të mblidhte nga një grusht e nga një grusht lesh. Kur e pa se me të mund ta bënte qilimin, e kreu, e torri, e ngeu ngjyra-ngjyra dhe e nderi të thahej. Si u bë gati leshi ind e majë, mendoi të ulej në tezgjah.

Ishte mëngjes pranvere, si sot, kur filloi nga endja e qilimit.

Bajamet sa kishin çelur.

Nika punonte dhe këndonte nën zë:

Mos e laj linjën kurrë,  
moj të keqenë,  
të njihesh që je pa burrë,  
moj të keqenë!



Mos e laj linjën fare,  
moj të keqenë,  
të njihesh që je beqare,  
moj të keqenë!

E bija e dëgjonte, e dëgjonte dhe i qeshej me porositë e asaj kënge, që shoqërohej dhe nga kënga e pandërprerë e tezgjahut.

Endja e qilimit po ecte ngadalë.

Shqetësimi i Nikës i hyri edhe së bijës, kur mblesërit e parë filluan të lëviznin nëpër rrugicat e lagjes.

Nika e porositi të bijën të qëndronte në krye të shkallëve dhe të priste. Kjo ishte edhe shenja se dera e saj e kishte gati për fejesë të bijën.

Vajza shihte herë nga porta dhe herë ndiqte punët e së ëmës në pritje të mbarimit të atij qilimi.

Sa shihte në krye të rrugicës ndonjë nga mblesërit e njohur të lagjes, e shqetësuar për ngadalësinë e endjes së qilimit, i drejtohej së ëmës për ta nxitur:

“Trashe, Nikë,  
të rëntë një pikë!...”

Kur mblesë merrte kthesën dhe i largohej

portës së saj, e dëshpëruar, i thërriste së ëmës të mos nxitohet, ta merrte më shtruar punën, se mblesë nuk kishte qenë për të:

“Tëholle, Nikë,  
i rëntë një pikë!...”

Ky dialog nënë-bijë vazhdoi me ditë, derisa Nika e mbaroi një ditë qilimin.

Atëherë e qetësuar e mbylli tezgjahun. U poq edhe koha e vajzës së saj.

Një ditë u dëgjua trokitja në portë. Ishte ai, mblesë.

Doli dhe e priti vetë me buzë duke qeshur me portën e hapur kanatë më kanatë.

Nika dhe vajza e saj kanë vite që e kanë lënë këtë botë, po kujtimin e tyre e mban gjallë kjo histori, që sapo ta tregova.

...

Mariana si e mbaroi rrëfimin, hyri në shtëpi për t’u marrë me punët e ditës.

Agim Mehqemeja

## Sporti në familje

## Sportistë në ekipet e para të qitjes

Nadiri dhe e motra Medineja Kokoshi e kanë ushtruar sportin e qitjes afro gjysmëshekulli më parë.

Nadiri ishte pjesëmarrës i grupit nismëtar që u aktivizua në ekip të bashku me të tjerët Vangjel Shkurti, Spiro Marini dhe qitësi Ali Qafa, dhe Medineja që në luftë me konceptet konservative ishte qitësja e parë që hyri në rrugën e sportit të qitjes.

Ky fillim i hershëm në ato vite të vështira, është një fakt për t'u vlerësuar edhe më shumë pjesëmarrja e të dy sportistëve të familjes Kokoshi.

Nadiri provoi dhe i zotëroi me sukses të dy llojet e armëve me të cilët bëhej në ato vite qitja, me armë luftarake dhe më vonë me armë sportive duke përfaqësuar me sukses ekipin "Tomori" në veprimtaritë kombëtare.

Pa i zbehur meritat e tij si qitës, ato janë më të mëdha në rolin e trajnerit, pasi ka ditur t'u transmetojë brezave përvojën e vet si qitës, duke i bërë ata qitës cilësorë.

Gjatë viteve si trajner së bashku me kolegët ka punuar në poligon me dhe pa orar, aq sa ka dhënë përshtypjen se Nadiri punon në sport dhe kjo lidhej me sedrën sportive që qitësit e "Tomorit" të arrijnë

Nadir Kokoshi, qitës-trajner.

rezultate në veprimtaritë kombëtare. Një tregues se si e qysh qitësat e "Tomorit" kushtet e mrekullueshme që ka poligoni për stërvitje t'i justifikojnë me rezultate të larta, kjo e bënte atë që Nadiri që kur ishte rasti për vështirësira financiare, ai nuk është kursyer e ka dhënë ndihmesën, që pa dyshim në ato vite, ka qenë një rast shumë i rrallë.

Nadiri ka meritë që së bashku me trajnerët ka formuar Plejadën e Artë të Qitjes "Tomori" më cilësorja në Shqipëri me 12 mjeshtra sporti, 10 kandidatë mjeshtra, 28 sportistë të kategorisë së parë. Disa prej qitësëve kanë qenë rekordmenë, kampionë, pjesëtarë të ekipeve kombëtare, fitues të anketave sportive, të titujve sportivë si Fatbardha Myzyri, Valentina Osmani, Rajmonda Harka, Merita Gega, Urma Allajbeu,

Medine Kokoshi

Mimoza Isollari, Liljana Bejko, Adriatik Toska, Shemsu Speci, Roland Marini.

Trajneri ka drejtuar ekipe me të dy sekset si në pistoletë ashtu edhe me pushkë dhe me të gjitha moshat. Ekipi i të rinjve ka dalë dy herë fitues në veprimtari kombëtare, i të rejave 3 herë, i fëmijëve 4 herë. Dhe kjo për meritë të drejtimit me profesionalizëm të trajnerit.

Nadiri ka luajtur rol të rëndësishëm në propagandimin e këtij sporti duke përgatitur edhe qitësia të ekipeve të shkollave, qendrave të punës të kooperativave bujqësore që kanë dhënë rezultate të mira në veprimtari kombëtare.

Mbas përfundimit të shkollës 7-vjeçare adoleshente nga lagjja Vakëf, Medineja, ishte e para vajzë beratase që mori pjesë në ekipin e qitjes duke mos

përfillur konceptet e shtrembëra që pengonin pjesëmarrjen e vajzave e grave në sport.

Medineja më tregoi se kishte një fillim shumë të vështirë sepse në vitin 1959 edhe numri i vajzave që aktivizoheshin në sport ishte i vogël dhe se ajo në fillim nuk kishte shoqe në qitje. Vështirësi kishim edhe kur udhëtonim për në qytete të tjera me kamionë e skoda, të prisnin orë të tëra nëpër stacione, të endeshin poshtë e lartë për të siguruar hotelin etj.

Edhe në familje nuk e kisha të lehtë, tregon Medineja, por me kalimin e kohës e sidomos me pjesëmarrjen e vëllait Nadirit në sport, punët ecën mirë.

Unë, tregon Medineja, i kisha marrë parasysh vështirësitë, prandaj edhe sakrifikova të gjithë vitet e rinisë për sportin. Me përpjekje afrova edhe shoqe të tjera në ekip, si: Hëna Gjergjani, Drita e Refije Sollaku, Xhemile Mara, Nikoleta Dani, Eli Nako, Feride Mara që, së bashku me to, po na kënaqnin rezultatet.

Kur u largova nga sporti nuk isha e qetë, por ndjeva edhe kënaqësi se po na zëvendësonin vajza që nuk i kishin ato telashe si ne, pasi

*Ekipi i të rejave me trajner Nadir Kokoshin*

*1959, Tiranë. Ekipi "Tomori", Medineja në qendër (ulur).*

ishim ne nismëtarët që ua kishin hapur këtë rrugë të bukur të sportit të qitjes.

Në vitin 1974, tregon Medineja, si veterane që isha, vajta në ditën e përrurimit të poligonit.

Ishte vërtetë një poligon i mrekullueshëm. Aty ishte krijuar një atmosferë e bukur sportive. Sot, përfundoi Medineja, kur shikoj poligonin krejt të ndryshuar, më duket si një poligon tjetër. Keq, shumë keq!

## Thumba sportive

- E çuditshme, kaluam me sukses në mbrojtje 89 minuta, por na i bënë golin në minutën e fundit.

- Harruat se ndeshja është 90 minuta.

\*\*\*

- Sa kërcëve me shkop?

- 1.80 m.

- Provo të kërcësh pa shkop, të siguroj se do të kërcësh më shumë.

\*\*\*

- Sa kapitenë ka ekipi juaj?

- Një. Përse pyet?

- Sepse në fushë më duken të gjithë kapitenë.

\*\*\*

- Gjithmonë pas ndeshjes jeni mësuar të bëni reklamime.

- Nuk është e vërtetë. Bëjmë reklamime vetëm kur humbasim.

\*\*\*

Një mbrojtës, kur ekipi i tij kishte pësuar 6 gola, gjatë lojës, i nervozuar, i thotë një golashënuesi:

- Hajde, provo të bësh më gol.

- Nuk do të bëj më jo, pasi më qortuan tifozët e mi.

## Josif Mio, fitues i konkursit sportiv

8 javë para përfundimit të kampionatit kombëtar të kategorisë së parë, u çel konkursi sportiv: "Do të hyjë "Tomori" apo jo në superligë?"

Në katër numra të gazetës "Lajmëtari" u botuan edhe mendime të disa tifozëve.

Në 39 pjesëmarrës, 38 kanë dhënë mendim se "Tomori" do të hyjë në superligë. I vetmi tifoz që ka dhënë mendim ndryshe (botuar edhe në gazetën "Lajmëtari", nr.12 datë 27 mars 2006), është Josif Mio, i cili është shpallur fitues i këtij konkursi sportiv.

Fituesit i jepet një vit falas gazeta "Lajmëtari".

Juria e konkursit sportive

*Në një takim pa asnjë interes beratasit kanë zhvilluar një nga lojrat e tyre më të dobëta duke marrë një barazim me Erzenin*

## Erzeni – Tomori, "paqe nën ullinj"

## FORMACIONET:

**Tomori:** Kotorri, Fani, Aliaj, Cufollari (Kuçi 72), Kurti, Lako, Dalipi (Shinko 46), G.Arbri, Prela, Peshtanaku,, Lamnica (Agalliu 71). Tr. K.Mile

**Erzeni:** Rizvani, Doku, Kapedani, Stavri, Bylyku, Arapi, Troplini (Gjeçi 75), Kamberi, Bërzezi (Peqini 84), Karaj (Shtrepi 67). Tr. F.Dollaku

**Gjyqtarë:** Kryesor P.Lapi (Shkodër), ndihmësa: I. Ziraj (Kuçovë), M.Dervishi (Shkodër)

Kartona të verdhë: nuk ka  
Kartona të kuq: nuk ka

Ashtu sic edhe ishte paralajmëruar, takimi midis Tomorit dhe Erzenit zhvilluar në Stadiumin "Tomori", ka ngjasuar më shumë me një ndeshje kontrolli, se sa me një takim zyrtar kampionati kombëtar. Të dyja skuadrat hynë dhe dolën nga fusha e

lojës pa asnjë pikë djerse

dhe më keq akoma kur asnjëra prej tyre nuk ka respektuar ata pak sportdashës, kryesisht fëmijë të moshës nën 16 vjeç, teksa janë tallur haptazi me ndjenjat e tyre. Me keqardhje duhet pranuar se ky kampionat tashmë ka hyrë në një fazë ku vetëm futboll nuk luhet, pra në një fazë kur futbollistët dhe trainerët kanë përcaktuar pozicionin

e tyre dhe aq u bën se sportdashësit vinë në stadium për tu dëfryer e jo për të dalë me nerva të ngritura. Është një realitet i hidhur të cilin po e përjetojmë me dhimbje edhe ne gazetarët që jemi të detyruar të shikojmë dhe pasqyrojmë edhe absurditetet të tilla si ky i takimit Tomori – Erzeni, ku asnjëra prej skuadrave nuk tregoi asgjë nga vlerat e saj. Në pjesën e parë të lojës skuadrat bënë nxemjen për të qenë të gatshme vetëm në pjesën e dytë, për faktin se topi rrallë e kaloi mesin e fushës të skuadrave respective. Tomori hyri në fushë pa Dinon, Bytyçin, Lalën, P. Arbrin duke aktivizuar mjaft futbollistë të rinj, ndërkohë që Erzeni kishte një formacion më të plotë. Gjithsesi, pavarësisht formacioneve të hedhura në fushë, skuadrat e kishin pararendosur barayimin duke nënshkruar "paqe nën ullinj" që pa nisur takimi, dhe kjo u pa nga mënyra se si u zhvillua 90 minutëshi. Në

pjesën e parë Tomori i krijohen disa raste për të shënuar si ato të minutave 4, 6, 24, 39 ku G.Arbri, Prela, Lamnica e Peshtanaku nuk kanë dashur të shënojnë ndërkohë që miqtë rreyikojnë vetëm në minutën e 34 me anë të Arapit. Me këto episode tepër të vakëta u mbzll pjesa e parë dhe ndërsa pritej që pjesa e dytë të ishte ndrzshe, u zhvillua kopje e së parës. Të dy trajnerët bënë zëvendësimet e plota dhe gjatë gjithë lojës qëndruan brenda stolit e pas takimit u larguan pa dhënë asnjë opinion për median. Pjesa e dytë ka shënuar vetëm dy episode : atë të minutës së 57 kur Shinko lëshoi një silurë në portën shijakase dhe Doku për miqtë në minutën e 80 rrezikoi me kokë. Përfundimisht, skuadrat morën nga një pikë, ndërkohë që futbollit me këtë mënyrë loje ka humbur shumë.

Rushan Dosti